



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 6345 Prot.

Tiranë, më 13.05.2024

**Lënda:** Përcillet për njohje Raporti i Treguesve mbi Indikatorët e Performancës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2023.

**KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 4, Tiranë.

Të nderuar,

Ju përcjellim për njohje Raportin e Treguesve mbi Indikatorët e Performancës për ASHK-në, për vitin 2023.

Me respekt,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Dallëndyshe BICI**





## AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS

### INDIKATORËT E PERFORMANCËS 2023



TIRANË, 05.01.2023

# INDIKATORËT E PERFORMANCËS 2023

## **I. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT**

1 – Aplikimet për shërbimet kadastrale.

## **II. PROCESET KALIMTARE TË PRONËSISË**

2 - Sektori i Mbikëqyrjes së Legalizimit të Ndërtimeve Informale dhe Trojeve pa Tituj.

3 - Realizimi i treguesve të procesit të legalizimit 2023.

4 - Treguesi “Vendime Legalizimi”.

5 - Realizimi treguesit të performancës “Vendime legalizimi të ngarkuara tek skeda digjitale”.

6 - Sektori i Tokës Bujqësore.

7 - Sektori i Procedurave të Kompensimit.

8 - Sektori i Mbikëqyrjes së Legalizimit të Ndërtimeve Informale dhe Trojeve pa Tituj.

## **III. QENDRA E KADASTRËS DIGJITALE**

## **IV. TRANSFERIMI I PRONAVE NGA INSTITUCIONET QENDRORE TEK NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

## **V. PRONAT SHITËTORE TË PUSHTETIT QENDROR**

9 – Plani për Vitin 2024.

## **VI. SEKRETARIATI TEKNIK I KOMISIONIT TË OBJEKTEVE TË KONFISKUARA PRANË ASHK-SË**

## **VII. SEKTORI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

10 - Plani për Vitin 2024.

## **VIII. SEKTORI JURIDIK DHE HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT**

11 - Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024.

## **IX. BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR**

12 - Shërbimet.

13 - Të ardhurat.

14 - Të ardhurat nga Taksa e kalimit të së Drejtës së Pronësisë për periudhën Janar-Dhjetor.

15 – Fondi Rezervë.

16 – Buxheti i planifikuar për ASHK-në për vitin 2024.

## **X. AMENDIMI I MARRËVESHJES SË PËRBASHKËT ASHK-DHKN PËR SHËRBIMET KADASTRALE**

## **XI. RIINXHINIERIZMI SISTEMIT**

17 - Aksesim i arkivave në mënyrë të pakontrolluar.

18 - Përdorimi i vulave të Institucionit në mënyrë të pakoordinuar dhe pa kriter.

19 - Mbyllja e sporteleve fizike.

20 - Riinxhinierizim.

## **XII. PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA**

## **XIII. SYNIMET PËR VITIN 2024 NE FUSHËN E DIGJITALIZIMIT**

21 - Sigurimi e ndërlidhjes me sistemin e Fiskalizimit për ASHK.

22 - Moduli i monitorimit të riskut.

23 - Teknologjia Blockchain.

24 - Moduli eProna

25 - Kadastra 3D

## **XIV. OBJEKTIVAT PRIORITARE TË ASHK, PËR VITIN 2024**

- **REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT PËR VITIN 2023.**

**I. APLIKIMET PËR SHËRBIMET KADASTRALE.**

Evidentimi i realizimit të treguesit të performancës për treguesin “Shërbimet e Kadastrës” (ku bën pjesë dhe treguesi “ASHK për Institucione”) bëhet nga databaza e të gjitha aplikimeve nga sistemi ALBSCAD i ASHK-së, që përcillet nga Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut i cili administron këto të dhëna. Në evidencën mujore përfshihen të gjitha aplikimet e paguara dhe pa pagesë (AV0) të muajit që monitorohet, për të cilat afati i marrjes së shërbimit kadastral të kërkuar është dita e fundit e muajit për të cilin hartohet performanca.


Në tabelën 1 pasqyrohen aplikimet për shërbime kadastrale të realizuara gjatë periudhës Janar-Nëntor 2023, sipas DV/ZV të ASHK-së.

Në tabelën 2 pasqyrohen aplikimet për shërbime kadastrale të realizuara gjatë periudhës Janar-Nëntor 2023, sipas DV/ZV të ASHK-së, brenda afatit dhe jashtë afatit.

Në tabelën 3 pasqyrohen aplikimet për shërbime kadastrale të realizuara gjatë periudhës Janar-Nëntor 2023, sipas DV/ZV të ASHK-së, grupuar sipas “aplikime të paguara” dhe “Aplikime me vlerë zero AV0”.

**APLIKIME PËR SHËRBIMET KADASTRALE, JANAR-DHJETOR 2023**

Drejtoria/Zyra	Aplikime Total			Aplikime e-Albania			Aplikime NISA			Aplikime sistemet e tjera		
	Total	Të paguara dhe me vlerë zero (AVO)	Përgjigjur	Total (e-albania)	Të paguara dhe me vlerë zero AVO (e-albania)	Përgjigjur (e-albania)	Total (NISA)	Të paguara dhe me vlerë zero AVO (NISA)	Përgjigjur (NISA)	Total sisteme të tjera	Të paguara dhe me vlerë zero AVO (sisteme të tjera)	Përgjigjur sisteme të tjera
BERAT	13,043	10,140	9,604	3,933	2,388	2,283	8,934	7,668	7,240	176	84	81
BULOIZE	1,195	755	719	807	492	472	343	262	246	45	1	1
DEVOLL	2,675	2,098	1,979	1,615	1,120	1,058	1,049	972	915	11	6	6
DIBËR	4,984	2,581	2,448	2,106	823	781	2,580	1,733	1,643	198	25	24
DR KAMEZ - VORË	26,689	22,025	21,315	10,850	8,102	7,829	15,812	13,872	13,437	27	51	49
DR RURALE 1	39,859	34,584	33,634	10,746	8,338	8,086	29,016	26,018	25,330	107	228	218
DR RURALE 2	38,275	32,601	31,641	11,031	8,039	7,814	27,160	24,391	23,664	84	171	163
DR TRANA JUG	47,714	40,188	38,989	14,569	9,985	9,624	32,950	29,923	29,100	195	280	265
DR TRANA VERË	73,878	69,224	57,165	22,656	13,328	12,866	50,980	45,489	43,923	242	407	376
DURRES	55,171	41,673	40,233	14,319	6,360	6,096	40,651	35,150	33,987	201	163	160
ELBASAN	22,310	17,846	16,971	7,096	4,233	3,977	15,151	13,559	12,944	63	54	50
FER	30,637	25,172	24,093	15,938	12,230	11,617	14,668	12,917	12,453	31	25	23
GIROKASTËR	8,974	6,785	6,426	5,842	4,192	3,937	3,103	2,574	2,470	29	19	19
GRAMSH	1,555	1,130	1,066	988	646	602	566	483	463	1	1	1
HAS	1,186	485	478	1,080	393	387	96	89	88	10	3	3
KAVAJË	23,027	18,817	18,087	6,876	4,727	4,512	16,103	14,058	13,545	48	32	30
KOLONJË	1,549	1,297	1,229	763	563	522	784	732	705	2	2	2
KORÇË	24,878	19,806	18,974	19,381	14,865	14,255	5,384	4,855	4,644	113	86	71
KRUJË	6,784	5,181	4,961	2,964	1,788	1,710	3,764	3,364	3,230	56	29	21
KUÇOVË	2,819	2,116	2,006	1,555	1,037	993	1,257	1,074	1,008	7	5	5
KUKËS	3,487	1,842	1,774	2,661	1,160	1,108	702	650	635	124	32	31
LAC	4,268	3,184	3,098	3,082	2,236	2,181	1,053	936	805	123	12	12
LEZHË	17,163	14,461	13,829	3,319	2,072	1,996	13,347	12,347	11,797	497	42	36
LIBRAZH	4,606	3,376	3,270	3,469	2,350	2,283	1,103	1,001	963	34	25	24
LUSHNJË	14,161	11,346	10,865	5,297	3,634	3,495	8,856	7,707	7,355	8	5	5
MALËSIE MADHE	1,585	1,343	1,282	869	617	585	779	718	689	37	8	8
MALLAKASTËR	1,861	1,542	1,477	1,621	1,349	1,289	233	187	182	7	6	6
MAT	2,566	1,114	1,060	1,764	532	513	726	550	516	86	32	31
MIRDITË	1,724	970	934	1,338	631	607	362	334	322	24	5	5
PEQN	1,944	1,662	1,578	1,254	301	286	1,530	1,359	1,290	2	2	2
PËRMET	2,496	2,026	1,915	4,12	833	884	1,226	1,080	1,018	16	13	13
POGRADEC	12,000	8,796	9,385	4,611	3,241	3,097	7,376	6,548	6,282	13	7	6
PUKË	1,021	686	650	662	374	350	336	307	295	23	5	5
SARANË	24,393	20,133	19,164	14,385	11,209	10,658	9,964	8,856	8,480	44	28	26
SHKODËR	24,518	18,103	17,146	10,870	6,584	6,186	12,984	11,301	10,736	684	216	214
SKRAPAR	1,471	1,111	1,058	532	340	326	931	766	727	8	5	5
TEPELENË	2,891	2,153	2,037	2,457	1,756	1,655	423	387	373	11	10	8
TROPOJË	2,072	1,034	974	1,578	588	547	469	435	417	25	11	10
VLORË	51,076	43,481	41,909	22,169	17,346	16,744	28,764	26,060	25,083	123	85	82
<b>TOTAL</b>	<b>1602,515</b>	<b>483,867</b>	<b>465,423</b>	<b>237,485</b>	<b>160,902</b>	<b>154,221</b>	<b>361,535</b>	<b>320,742</b>	<b>309,114</b>	<b>3,515</b>	<b>2,228</b>	<b>2,088</b>



## II. PROCESET KALIMTARE TË PRONËSISË.

Referuar ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Monitorimit të Proceseve Kalimtare raporton sa vijon:

- **Spektori i Mbikëqyrjes së Legalizimit të Ndërtimeve Informale dhe Trojeve pa Tituj:**

Në objektivat e sektorit të mbikëqyrjes së legalizimit të ndërtimeve pa leje, fokusi kryesor ka qenë trajtimi i ankesave të qytetarëve të cilët kryesisht kanë kërkuar konkludimin e procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje në posedim të tyre në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe kritereve të përcaktuara në VKM nr. 1040/2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe zbatimit të kritereve të legalizimit...”, si dhe miratimin e dokumenteve të pronësisë për objektet pa titull pronësie të ndërtuara para vitit 1991 dhe truallit funksional”, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 20/2020 dhe VKM nr. 827/2020 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull...”.

Gjithashtu, drejtoritë vendore në fillim të vitit 2023, janë orientuar për hartimin e një plani të detajuar masash, për trajtimin me prioritet dhe përmbylljen e procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje, të aplikuara gjatë viteve 2005-2006, me arsyetimin se kanë përparësi në marrjen e shërbimit ata që kanë aplikuar më herët krahasuar me ata që kanë aplikuar më vonë.

## Realizimi i treguesve të procesit të legalizimit 2023.

Realizimi i treguesve të procesit të legalizimit, monitorohet në bazë periodike mujore nga Sektori i Analizës dhe Statistikave.

Evidentimi i realizimit për treguesin “Vendime Legalizimi” bëhet nga Moduli i Lejeve të Legalizimit, ku secila Drejtori Vendore pasqyron vendimet e legalizimit që ka miratuar gjatë muajit që monitorohet, duke plotësuar në modul numrin e vendimit, datën, si dhe të dhënat e tjera sipas rubrikave të modulit. DV kanë detyrimin ligjor që të pasqyrojnë në Modulin e Legalizimeve si dhe Skedën Digjitale, të gjitha vendimet e legalizimit/moslegalizimit që miratojnë, brenda muajit përkatës. Monitorimi i performancës mujore bëhet vetëm mbi bazën e vendimeve të Legalizimit/moslegalizimit të pasqyruara në Modulin e Lejeve të Legalizimit/skedën digjitale. Normativa mujore është 2,455 vendime legalizimi. Rishikimi i fundit i normativës mujore është bërë në muajin shtator 2020.

Normativa mujore e treguesit “Vendime legalizimi të ngarkuara tek skeda digjitale” është 14.455 vendime legalizimi/moslegalizimi.


Normativa mujore e treguesit të performancës “Vendime të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore për objektet e ndërtuara para vitit 1991” është 355 vendime.

### 1. Treguesi “Vendime Legalizimi”


JANAR - DHJETOR 2023

MUAJI	VENDIME LEGALIZIMI				
	NORMATIVA MUJORE	REALIZIMI PËR SECILIN MUAJ			
		LEGALIZIME	MOS-LEGALIZIME	LEGALIZIME + MOS LEGALIZIME	REALIZIMI NË %
JANAR	2,455	1,275	18	1,293	52.7%
SHKURT	2,455	1,336	13	1,349	54.9%
MARS	2,455	1,666	32	1,698	69.2%
PRILL	2,455	486	17	503	20.5%
MAJ	2,455	1,050	15	1,065	43.4%
QERSHOR	2,455	778	40	818	33.3%
KORRIK	2,455	786	26	812	33.1%
GUSHT	2,455	640	0	640	26.1%
SHTATOR	2,455	580	0	580	23.6%
TETOR	2,455	547	0	547	22.3%
NËNTOR	2,455	534	10	544	22.2%
DHJETOR	2,455	411	4	415	16.9%
<b>JANAR - DHJETOR</b>	<b>29,460</b>	<b>10,089</b>	<b>172</b>	<b>10,264</b>	<b>34.8%</b>

### NR. I VENDIMEVE TË LEGALIZIMIT SIPAS MUAJVE



### REALIZIMI I NORMATIVËS SË VENDIMEVE TË LEGALIZIMIT, SIPAS MUAJVE, NË %





**2. Realizimi treguesit të performancës “Vendime legalizimi të ngarkuara tek skeda digjitale”.**

**TREGUESI I PERFORMANCËS MUJORE, SKEDA DIGJITALE**

**JANAR - DHJETOR 2023**



MUAJI	VENDIME TË LEGALIZIMIT TË NGARKUARA TEK SKEDA DIGJITALE		
	NORMATIVA MUJORE	REALIZIMI PËR SECILIN MUAJ	
		VENDIME TË NGARKUARA	REALIZIMI NË %
JANAR	14,455	1,006	7.0%
SHKURT	14,455	1,117	7.7%
MARS	14,455	1,027	7.1%
PRILL	14,455	514	3.6%
MAJ	14,455	262	1.8%
QERSHOR	14,455	725	5.0%
KORRIK	14,455	352	2.4%
GUSHT	14,455	148	1.0%
SHTATOR	14,455	268	1.9%
TETOR	14,455	234	1.6%
NËNTOR	14,455	40	0.3%
DHJETOR	14,455	61	0.4%
<b>JANAR - DHJETOR</b>	<b>173,460</b>	<b>5,754</b>	<b>3.3%</b>





*JANAR - DHJETOR 2023*

MUAJI	VENDIMET E KALIMIT TË PRONËSISË SË PARCELËS NDËRTIMORE PËR OBJEKTET E NDËRTUARA PARA VITIT 1991		
	NORMATIVA MUJORE	REALIZIMI PËR SECILIN MUAJ	
		VENDIME	NE %
JANAR	355	97	27.3%
SHKURT	355	156	43.9%
MARS	355	137	38.6%
PRILL	355	73	20.6%
MAJ	355	93	26.2%
QERSHOR	355	97	27.3%
KORRIK	355	75	21.1%
GUSHT	355	50	14.1%
SHTATOR	355	50	14.1%
TETOR	355	96	27.0%
NËNTOR	355	92	25.9%
DHJETOR	355	82	23.1%
<b>JANAR - DHJETOR</b>	<b>4,260</b>	<b>1,098</b>	<b>25.5%</b>



- **Spektori i tokës Bujqësore:**

Në zbatim të VKM-së nr. 320 datë 31. 05.2023 “Për ngritjen e task-forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020”, ASHK (Agjencia Shtetërore e Kadastrës), nëpërmjet sekretariatit teknik ka vijuar bashkëpunimin me Task Forcën për të bërë të mundur vijimin e trajtimit të kërkesave për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi për qarkun Shkodër.

Aktualisht, janë shqyrtuar 4118 kërkesa për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, konkretisht 2,493 kërkesa në Bashkinë Malësi e Madhe, 1182 kërkesa në Bashkinë Shkodër, 368 kërkesa në Bashkinë Pukë dhe 75 kërkesa në Bashkinë Vau i Dejës.

Nga shqyrtimi i këtyre kërkesave janë përpiluar njoftime individuale për subjektet aplikuese për Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau Dejës. Jemi në pritje të plotësimit të dokumentacionit nga aplikuesit, sipas njoftimeve të bëra për secilin.

Në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe ka filluar procesi i verifikimit në terren të ngastrave të pretenduara me qëllim saktësimin e kufijve dhe përcaktimin e sipërfaqes së kërkuar.

- Janë përgatitur planvendosjet e ngastrave për kryerjen e verifikimeve në terren për 195 subjekt dhe posedues kufitar, të cilëve ju korespondojnë 225 parcela.
- Janë përgatitur aktet e konstatimit për 127 parcela.
- Janë hartuar planvendosjet përfundimtare për 127 parcela.
- Nga kërkesat e trajtuara deri më tani, vetëm 10 subjekte vijnë të kenë plotësuar marrëveshjen noteriale të poseduesit të tokës bujqësore me kufitarët, kjo është një përqindje shumë e vogël në krahasim me numrin e kërkesave. *(Nuk kemi të dhëna të përditësuara nga raportimi i fundit).*
- Subjektet e tjera janë njoftuar, por nuk janë paraqitur në terren në mënyrë që të kryen verifikimet dhe matjet e nevojshme për përgatitjen e planvendosjeve.
- Janë përcjellë pranë Bashkisë Malësi e Madhe për të kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak lista e përdoruesve, relacionet dhe planvendosjet përkatëse për 2 subjekte të cilët kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për 13 parcela. *(Nuk kemi të dhëna të përditësuara nga raportimi i fundit).*

- **Sektori i Procedurave të Kompensimit:**

Gjate vitit 2023 sektori i procedurave të kompensimit në Drejtorinë e Monitorimit të Proceseve Kalimtare, në Drejtorinë e Përgjithshme e ASHK-së ka hartuar gjithsej 7 projekt vendime për: *“Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara”* të detajuara si më poshtë:

1. Projekt VKM-ja dërguar pranë Kryeministrisë me shkresën nr.13520 prot, datë 5.10.2023 me nr. total të pronave që kompensohen 175, sipërfaqe totale që kompensohet 39 279.54 m<sup>2</sup>, shuma totale që kompensohet 266 494 525.23 leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë: Tirana Jug, Tirana Veri, Rurale 1, Rurale 2, Kamzë-Vorë, Elbasan, Berat, Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Zonat e Stimuluara, Kavajë dhe Vlorë.
2. V.K.M nr. 635 dt 15.11.2023 me nr. total të pronave që kompensohen 290, sipërfaqe totale që kompensohet 64 205.8 m<sup>2</sup>, dhe shumë totale që kompensohet 625 429 393.8 leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë: Lezhë, Gjirokastrë, Tirana-Veri, Tirana-Jug, Rurale 1, Rurale 2, Lushnje, Kamzë Vorë, Elbasan, Durrës, Shkodër Kavajë, Vlorë.
3. V.K.M nr. 410, datë 7.07.2023 me nr. total të pronave që kompensohen 292, sipërfaqe totale që kompensohet 70 173.4 m<sup>2</sup>, dhe shumë totale që kompensohet 507 537 720.45 leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë: Tirana Veri, Elbasan, Tirana Jug, Tirana Rurale 1, Kamzë-Vorë, Tirana Rurale 2, Gjirokastrë, Kuçovë, Vlorë, Durrës, Berat dhe Sarandë.
4. V.K.M nr. 744, datë 20.12.2023 me nr. total të pronave që kompensohen 233, sipërfaqe totale që kompensohet 68 958 m<sup>2</sup>, dhe shumë totale që kompensohet 579 593 115.7 leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet: janë Tirana Veri, Tirana Jug, Rurale 1, Elbasan, Vlorë, Kamzë-Vorë, Durrës, Zonat e Stimuluara dhe Kavajë.

5. Projekt VKM-ja dërguar pranë Kryeministrisë me shkresën nr.13071/2 prot, datë 19.10.2023 me nr. total të pronave që kompensohen **239**, sipërfaqe totale që kompensohet **46 690,8** m2, shuma totale që kompensohet **556 268 826.45** leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë: Tirana Veri, Tirana Jug, Rurale 1, Elbasan, Kamëz-Vorë, Vlorë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Tirana Rurale 2, Kucovë, Kavajë, Krujë, Sarandë.
6. Projekt VKM-ja dërguar pranë Kryeministrisë me shkresën nr.15399 prot, datë 16.11.2023 me nr. total të pronave që kompensohen **171** sipërfaqe totale që kompensohet **40 540.6** m2, shuma totale që kompensohet **357 679 111.64** leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë Tirana Veri, Tirana Jug, Kamëz-Vorë, Fier, Tirana Rurale 2, Tirana Rurale 1, Elbasan, Zonat e Stimuluara , Krujë, Gjirokastrë, Vlorë, Kavajë, Lezhë, Durrës.
7. Projekt VKM-ja dërguar pranë Kryeministrisë me shkresën nr.16788 prot, datë 28.11.2023 me nr. total të pronave që kompensohen **203** sipërfaqe totale që kompensohet **39 935.7** m2, shuma totale që kompensohet **509 743 164.81** leke. Drejtoritë Vendore të ASHK-ve që kanë bërë propozimet janë: Elbasan, Tirana Veri, Tirana Rurale 2, Tirana Rurale 1, Tirana Jug, Vlorë, Durrës, Shkodër, Kamëz-Vorë, Zonat e Stimuluara, Sarandë, Fier, Gjirokastrë, Kavajë dhe Pogradec.

#### Plani për vitin 2024

##### **- Sektori i Mbikëqyrjes së Legalizimit të Ndërtimeve Informale dhe Trojeve pa Tituj:**

Ndryshimet e shumta ligjore dhe ekonomike si dhe duke patur në konsideratë ndjeshmërinë dhe rëndësisë që karakterizon çështjen e pronave është konsoliduar tashmë korniza ligjore e regjimit pronësor me miratimin e ligjit nr.20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”* dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në zbatim të këtij kuadri ligjor synohet të realizohen në vijim edhe për vitin 2024 objektivat për përfundimin e proceseve tranzitore të legalizimit dhe regjistrimit në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, të ndërtimeve pa leje, objekteve dhe trojeve funksionale, kur mungojnë aktet e fitimit të pronësisë, si dhe të oborreve në përdorim.

Nga sektori i mbikëqyrjes së legalizimit të ndërtimeve informale dhe trojeve funksionale pa tituj pronësorë do të vijohet me monitorimin dhe mbikëqyrjen e trajtimeve të aplikimeve nga DVASHK vendore duke u fokusuar:

- Në aplikimet e bëra në vitet 2005-2006 në respektim edhe të angazhimeve të ndërmarra tashmë për t’ju ofruar shërbim qytetarëve të cilët kanë aplikuar më parë në kohë, krahasuar me të tjerët që kanë aplikuar më vonë.
- Në trajtimin me prioritet të ankesave të qytetarëve lidhur me këto dy procese të rëndësishme.
- Në mbajtjen e korrespondencave të herëpashershme me DVASHK vendore lidhur me ecurinë e këtyre dy proceseve në drejtoritë përkatëse.

- Në evidentimin e problematikave, që hasen përgjatë trajtimit të këtyre aplikimeve, në bashkëpunim dhe koordinim me drejtoritë vendore, me synim përshpejtimin dhe vijueshmërinë e realizimit të këtyre proceseve kalimtare.

Gjithashtu në frymë edhe të ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, për realizimin dhe trajtimin e njëkohshëm të proceseve të ndryshme të lidhura me pronën si dhe për koordinimin e këtyre proceseve synojmë të realizojmë monitorim dhe mbikëqyrje bazuar edhe mbi planin e masave të hartuara nga drejtoritë vendore.

Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, me Urdhërin nr.2599 date 21.12.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ka ngritur Grupin e punës, me anëtarë nga Drejtoria e Monitorimit të Proceseve Kalimtare, Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes si dhe Drejtoria e Projekteve Kontrollit dhe Analizës, grup i cili do të ushtrojë kontroll në të gjitha Drejtoritë/Zyrat Vendore lidhur me masat e marra në zbatim të Udhëzimit nr.689 datë 11.01.2023 për vetdeklarimet për vitet 2005-2006, plotësimin e të dhënave mbi vendimmarrjen në Protokollin elektronik të Transferimit të skedareve (FTP) dhe skedën digjitale të objekteve pa leje në zbatim të Udhëzimit nr.1520 datë 02.11.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, zbatimi i procedurave administrative dhe dokumentacionit për vendimmarrjet për legalizim/moslegalizimi/pezullim për kërkesat e paraqitura për legalizim, për të cilat nuk ka vendim përfundimtar për legalizim/skualifikim të objektit, nëse ka një plan të detajuar masash ku të jenë përcaktuar afate konkrete për përfundimin e procedurave administrative deri në vendimmarrje etj.

#### **- Sektori i Tokës Bujqësore**

Sa i përket planit për vitin 2024 ju bëjmë me dije se, procesi i regjistrimit të AMTP-ve dhe i kalimit të tokës bujqësore në pronësi pa shpërblim, është një proces dinamik dhe me shumë problematika, proces i cili kërkon bashkëpunimin midis Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, drejtorive vendore të ASHK, pushtetit vendor dhe Task Forcës për Tokat Bujqësore.

Se pari, ky proces lidhet ngushtë me dokumentacionin e ndarjes së tokës bujqësore të administruar në ASHK në zbatim të pikës 6 të nenit 68 të ligjit nr.20/2020, që përcakton detyrimin e Bashkive /NJ Administrative, respektivisht kopje të dokumentacionit arkivor për procesin e ndarjes së tokës bujqësore. Ndërsa pika 3 e VKM 1182/2020 përcakton se *“të gjitha institucionet kanë detyrimin të dorëzojnë arkivat dhe dokumentacionin përkatës për reformën agrare para vitit 1946, për dhënien në përdorim dhe pronësi të tokës bujqësore, përfshirë hartat dhe regjistrat e kadastrës së tokës bujqësore, për verifikimin e titujve të tokës bujqësore dhe çdo dokument që ka lidhje me to”*.

Detyrim i cili nuk është përmbushur ende plotësisht nga institucionet përkatëse.

Së dyti, lidhet ngushtë me Planifikimin dhe përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në Zonat Kadastrale pa regjistrim fillestar në territorin e Republikës së Shqipërisë, planifikim i cili është i kushtëzuar nga fondet financiare të nevojshme për kryerjen e

procedurave përkatëse, si dhe për zonat të cilat kanë nevojë për përmirësim/përditësim nga Qendra e Kadastrës Digjitale (QKD).

Sa më sipër, duke shpresuar në bashkëpunimin dhe angazhimin e plotë të institucioneve, besojmë se do të arrijmë të përmbushim qëllimet e ligjit nr. 20/2020, VKM Nr. 1174/2020 dhe VKM Nr. 1182/2020.

### **III. QENDRA E KADASTRËS DIGJITALE**

Digjitalizimi i plotë i arkivës dhe i dokumentacionit është sipërmarrja madhore e Qendrës së Kadastrës Digjitale. Objektivi është “tituj të qartë dhe të sigurtë pronësie”. Tashmë ASHK ka hyrë në një epokë të re, në të cilën ky institucion nevojitet t’i përgjigjet zhvillimeve dinamike që aktualisht shoqëria shqiptare po kalon. Dhe vetëm procesi i digjitalizimit, si detyra kryesore e Q.K.D, mund të zgjidhë një herë e përgjithmonë problematikën e pronës në Shqipëri, ku produkti i digjitalizimit të kartelave dhe hartave të pasurive të paluajtshme sjell:

- Një prone të sigurt;
- Eliminimin e pasaktësive në dokumentat kadastrale të pasurive të paluajtshme, ku çdo qytetar do të disponojë e gëzojë pronën e tij sipas gjendjes faktike në terren;
- Marrjen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në kohë reale;
- Sigurimin e arkivit të pronës, nëpërmjet skanimit të gjithë materialit hartografik dhe shkresor të çdo prone në R.SH (referencave);
- Skanimin dhe arkivimin e regjistrave të vjetër, duke eliminuar çdo mundësi dëmtimi të tyre, nga pakujdesia, apo çdo arsye tjetër.

Per arsyet e përmendura më sipër, Qendra së Kadastrës Dixhitale është një domosdoshmëri për nevojat aktuale të shoqërisë shqiptare për zgjidhjen e problematikave mbi pasuritë e paluajtshme.

QKD – ja është e ndarë në gjashtë (6) sektor funksional,

Sektori i Skanimit

Sektori i Digjitalizimit

Sektori i Përmirësim/Përditësimit

Sektori i Regjistrimit Fillestar

Sektori i Terrenit

Sektori i Finances, Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese

**Sektori Skanimit**, me një grup prej 70 specialistësh (ose 35 çift/specialistësh) po punon në disa drejtori si: Vlorë, Sarandë, Përmet, Elbasan, Lac, dhe Shkodër. Me një normë ditore prej 250 referencash ne dite per çift/specialistesh, Sektori Skanimit ka skanuar deri me sot me shume se 770.000 referenca dhe afro 3.960 volume kadastrale ne keto drejtori por edhe ne drejtorite si Lushnje, Tropoje, Kavaje, Durres, Kruje, Diber, Korce, Pogradec , Gramsh, Gjirokaster, tashme te perfunduara.

Objektivi, është → gjate vitit 2024, me kete staf Sektori i Skanimit synon të skanojë rreth 1.475.000 referenca dhe 3.440 volume kadastrale.

Shifra keto që jane ekuivalente me mesataren :

- 3 drejtorive te medha te tilla si Fier, Tirane, Berat,
- ose me 15 drejtori te vogla/mesatare si Lac, Peqin, Lezhe, Librazhd etj.

Puna e kryer ne qytetet me statistikat perkatese vijojne si me poshte:

- 1 - DV Lushnje - 68.000 ref. + 710 Volume, Prill - Shtator 2022
- 2 - DV Tropoje - 6300 ref. + 137 Volume, Korrik 2022
- 3 - DV Durresi - 204.000 ref. + 1072 Volume, Korrik 2022- Mars 2023
- 4 - DV Kruja - 43.000 ref. + 302 Volume, Shtator 2022- Qershor 2023
- 5 - DV Kavaja - 87.000 ref. + 690 Volume, Shtator 2022- Korrik 2023
- 6 - DV Elbasan - 56.000 ref. , Qershor 2023- Vazhdon
- 7 - DV Shkoder – 25.0000 ref. , Gusht 2023 - Vazhdon
- 8 - DV Diber - 30.000 ref. + 54 Volume, Mars-Gusht 2023
- 9 - DV Korce - 57.000 ref. Shkurt-Qershor 2023
- 10 - DV Pogradec - 58.000 ref. Shkurt - Korrik 2023
- 11 - DV Gjirokaster - 20.000 ref. + 588 Volume Korrik- Gusht 2023
- 12 - DV Sarande - 51.000 ref. + 310 Volume, Shkurt 2023 - Vazhdon
- 13 - DV Vlore - 40.000 ref. , Korrik 2023 - Vazhdon
- 14 - DV Gramsh – 20.000 ref. + 268 Volume, Nentor 2023

Marrë shkas nga procesi aktual i procesimit të praktikave në ASHK, ky sektor i vjen shume në ndihme drejtorive vendore, konkretisht operatoreve, në furnizimin me referenca origjine aplikimeve te ndryshme.

Gjithashtu, është ndihmë dhe mbështetje shume e rëndesishme e sektoreve te Përmirësim/Përditësimit si dhe Regjistrimit Fillestar. Në skanimin e materialeve për zonat të cilat hyjnë në këtë proces.

**Spektori Digjitalizimit**, ka për detyre kalimin në formatin digjital të kartelave të pasurive. Konkretisht të volumeve fizike të pasurive sipas zonave kadastrale ndodhura pranë drejtorive vendore dhe digjitalizimin e tyre. Ky sektor, aktivizohet pasi është sjelle produkti (dokumentacioni i skanuar) nga Spektori i Skanimit.

Funksionimi i këtij sektori, është i bazuar, kryesisht ne ligjin nr.111/2018 (per kadastrën), Urdhrin e Kryeministrit me Nr.15, datë 31.01.2022 (miratimin e strukturës dhe

organikës...ASHK), Urdhëri nr.2860 datë 30.08.2022, Urdhëri nr.1931 datë 20.04.2022 (miratimin e proceseve, etj....)

Origjina e këtij sektori, është ajo që dikur quhej “Projekti”.

Gjatë vitit 2023 Sektori i Digjitalizimit ka përfunduar me sukses digjitalizimin e kartelave të pasurive të paluajtshme të DV ASHK Lushnje, ZV ASHK Tropojë dhe DV ASHK Krujë.

- DV ASHK Lushnje ka gjithsej 122 Zona Kadastrale, më 731 Volume Kadastral. Në total janë digjitalizuar 162’750 Kartela Kadastrale.
  - ZV ASHK Tropoje ka gjithsej 47 Zona Kadastrale, më 133 Volume Kadastral. Në total janë digjitalizuar rreth 33’250 Kartela Kadastrale.
  - DV ASHK Krujë ka në gjithsej 42 Zona Kadastrale, me 298 Volume Kadastral. Në total janë digjitalizuar 54’500 Kartela Kadastrale.
  - DV ASHK Durrës në total janë digjitalizuar 286’939 Kartela Kadastrale.
  - DV ASHK Dibër është digjitalizuar në fazë të parë, me një total prej 11’767 kartela kadastrale.
  - DV ASHK Kukës është digjitalizuar në fazë të parë, me një total prej 8’976 kartela kadastrale.
- Në janar të vitit 2023 filloi procesi i digjitalizimit me DV ASHK Durrës. Durrësi është ndarë përafërsisht në 21 faza dhe ka gjithësej **1062 volume kadastral** me rreth 255’000 kartela kadastrale, aktualisht jemi në proces digjitalizimi në fazën e dymbëdhjetë.

Aktualisht, në rang vendi janë dixhitalizuar rreth 505.400 kartela pasurie dhe kanë kaluar në sistemin multifunksional. Procesi është në vijim dhe nr i kartelave të digjitalizuara ndryshon dita ditës.

Sektori i Digjitalizimit ka një staf prej 105 punonjësish, me mundësi rritje të nr të tyre. Për sa i përket procesit të digjitalizimit, punonjësit janë të organizuar në funksione të ndryshme nga ku monitorohen nga shefi i sallës.

Janë rreth 90 specialistë të cilët kryejnë hedhjen e të dhënave kadastrale në përputhje me kartelen fizike në aplikacionin e digjitalizimit të kartelës (e-Pasuritë), të volumit kadastral të skanuar, të administruar nga Sektori i Skanimeve.

Nga një specialist digjitalizohen 60 kartela në ditë sipas normës së miratuar me urdhërin nr.2860 datë 30.08.2022. Procesi i hedhjes së të dhënave kadastrale të një volumi me 250 faqe mund të zgjasë deri në 6 ditë pune.

Sektori i Digjitalizimit, nuk mund të fillojë një zonë tjetër apo fazë tjetër të zonës ku punohet, pa u ezauruar urdhëri i fazes aktuale, pasi sistemi e-Pasuritë është i ndërtuar në mënyrë të tillë, që çdo kartelë e hedhur (zakonisht rreth 15000-18000 kartela për fazë) nëse nuk ngarkohen në sistemin multifunksional, fshihet puna e kryer e fazës aktuale. Që do të thotë, një fazë me rreth 15000-18000 kartela gjithsej, duhet të fillojë dhe mbarojë i gjithë procesi nga hedhja e të dhënave deri në ngarkimin e tyre në multifunksional e më pas verifikimi i përplasjeve që mund të ndodhin me dublikimet gjatë implementimit në sistemin multifunksional dhe vetëm pas kësaj mund të procedohet me digjitalizimin e fazës apo zonës tjetër.

Aktualisht kemi 19 Kontrollorë (ky nr ndryshon sipas nevojave të QKD-së), që ushtrojnë funksionin e kontrollit të brëndshëm të cilësisë së kartelave të digjitalizuara nga Specialistët si dhe verifikimin e kartelave të kthyer gjatë importimit në sistemin multifunksional. Këta kontrollorë kryejnë kontrollin e kartelave pas përfundimit të hedhjes së të dhënave në sistem, në mënyrë që të eliminohen 100% gabimet si dhe në përfundim të çdo faze kryhet hartimi i proces-verbalit dhe raportit. Një kontrollor kryen në ditë rreth 125 kartela duke përfshirë edhe rivlerësimet e hasura gjatë ushtrimit të kontrollit. Një volum relativisht i ngarkuar mund të marrë deri në 3 ditë pune për tu ezauruar pjesa e kontrollit së bashku me rivlerësimet. Pas ezaurimit të kontrollit dhe pas fazës së ngarkimit në multifunksional, kontrollorët kryejnë verifikimet e kartelave të kthyer nga sistemi multifunksional, një pjesë e të cilave ri-hidhen nga specialistet dhe pjesa tjetër për të cilën QKD nuk ka tagër ndërhyrjeje i dërgohet Drejtorisë Vendore për verifikim dhe korigjim të mëtejshëm, në përputhje me nenin 16 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

Spektori i Digjitalizimit ka në dispozicion dy specialist IT, që përveç mbarëvajtjes së serverit dhe mjeteve teknologjike të punës, kryejnë edhe ngarkimin e kartelave të digjitalizuara në multifunksional, pas administrimit të shkresës nga Drejtoria e Përgjithshme për implementimin e produktit të Sektorit të Digjitalizimit në sistemin Multifunksional.

Përfundimi i procesit të digjitalizimit, do të thotë:

- Veprim i shpejtë i specialistit në DV të cdo qyteti, nëpërmjet sistemin Multifunksional,
- Marrjen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në kohë reale,
- Kursim në burime njerëzore, (problem aktual i theksuar për burime njerëzore të kualifikuar, aq me teper në zona periferike)

**Objektivat → Gjatë vitit 2024 objektivi kryesor është përfundimi i digjitalizimit të qyteteve si Gramshi, Saranda, Gjirokastra dhe Kavaja.**

Sipas ecurisë së këtij viti që po lëmë pas, pa dyshim që ky sektor do të arrijë të përmbushë me performancë edhe më të shkelqyer objektivat e vitit 2024.

**Spektori i Përmirësim/Përditësimit** pranë Qendrës së Kadastrës Digjitale, funksionon në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.15, datë 31.01.2022 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i cili ka si kompetencë kryerjen e procesit të Përmirësim/Përditësimit.

Para krijimit të Qendrës së Kadastrës Digjitale, ky proces kryhej nga drejtoritë vendore përkatëse.

Pas ngritjes dhe funksionimit të Qendrës së Kadastrës Digjitale, me urdhrin nr.2594, datë 12.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së është përcaktuar se: *Të gjitha blloqet kadastrale për të cilat ka nisur procesi i Përmirësimit të Regjistrimit dhe Hartës Kadastrale nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, do të përcillen për trajtim pranë Qendrës së Kadastrës Digjitale, përveç blloqeve për të cilat ka përfunduar Faza e Parë e Kontrollit.*

Më poshtë, po ju paraqesim një përmbledhje të shkurtër mbi mënyrën e funksionimit të Sektorit të Përmirësim/Përditësimit dhe fazat në të cilat kalon ky proces.

- Baza ligjore ku fokusohet e gjithë veprimtaria e këtij sektori është ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 11.01.2023 “Për rregullat e hollësishme, mënyrat dhe mjetet tekniko-hartografike për përmirësimin e regjistrit kadastral”, ligji 20/2020 (per perfundimin e proceseve kalimtare...) si dhe Urdhri nr.1090, datë 08.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

- Funksionimi i Sektorit të Përmirësim/Përditësimit ka filluar në muajin Prill të vitit 2022, moment në të cilën ka vazhduar puna për Përmirësim/Përditësimin e disa Zonave Kadastrale të ndodhura në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën” përcaktohet se:

- 1. *“Përmirësimi është procesi i saktësimit të kufijve, të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme, pasqyrimin të drejtë në hartën kadastrale të pozicionit gjeografik, si dhe saktësimin të të dhënave të regjistrin të pasurive.*

- 2. *Përmirësimi zbatohet në dy nivele, që janë: a) saktësimi dhe korigjimi i hartës kadastrale, në raport me titujt e pronësisë dhe gjendjen faktike të pasurive; b) përputhja e të dhënave të titullit të pronësisë me gjendjen faktike.*

- Sektori i Përmirësim/Përditësimit ka një staf të kualifikuar prej **38 punonjësish**, prej të cilëve 38 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori, të specialiteteve **Inxhinier Hartograf (18 specialistë)** dhe **Jurist (20 specialistë)**, që kryejnë realizimin e procesit të Përmirësim/Përditësimit, të organizuar në grupe që përbëhen nga 1 hartograf dhe 1-2 juristë, në bazë të numrit të kërkesave të paraqitura dhe problematikave të ndryshme. Numëri i specialistëve është gjithmonë në rritje, përshkak të volumit të punës i cili është në rritje.

Procesi i Përmirësim/Përditësim kryhet nga **QKD-ja**, mbi bazën e kërkesave të dërguara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Drejtoria e Përgjithshme ose Drejtoritë Vendore) dhe subjekteve të ndryshme private.

Pas verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesës për Përmirësim/Përditësim nga Përgjegjësi i këtij sektori, me urdhër të Drejtorit të Qendrës së Kadastrës Digjitale krijohet Grupi i Punës për fillimin e procesit, i cili përbëhet nga **1 jurist dhe inxhinier hartograf**. Më pas hartohet relacioni tekniko-ligjor mbi shkakun e përmirësimit të regjistrin, sipas parashikimeve të **VKM-së nr.4, datë 11.01.2023**. Qendra e Kadastrës Digjitale njofton Drejtorinë Vendore përkatëse, për fillimin e procesit të Përmirësim/Përditësimit dhe pezullimin e veprimeve kadastrale për pasuritë që preken nga ky proces.

Fazat në të cilat kalon procesi i Përmirësim/Përditësimi janë:

- a) Mbledhja e informacionit dhe dokumentacionit të administruar në drejtoritë vendore të ASHK-së për pasuritë që preken nga procesi.
- b) Përgatitja e relacionit për Sektorin e Verifikimit të Terrenit dhe matjet fushore përkatëse.
- c) Hartimi i produktit digjital me të dhënat e regjistrin, si tërësia e kartelave të pasurive të paluajtshme dhe hartave kadastrale të përmirësuar.
- d) Dërgimi për Kontroll i materialit fillestar të procesit të Përmirësimin në Njësinë e Kadastrës dhe Hartografisë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.

- e) Pas shqyrtimit të Raport-Kontrollit për materialin fillestar bëhet Shpallja Publike e bllokut kadastral që i është nënshtruar procesit sipas parashikimeve të nenit 31 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.
- f) Dokumentacioni i shpalljes përbëhet nga harta kadastrale e zonës e lidhur me listën e pasurive dhe pronarët përkatës, pas përmirësimit.
- g) Vlerësimi i ankesave dhe pretendimeve mbi produktin e përmirësimit dhe pasqyrimi i tyre sipas afateve ligjore.
- h) Kontrolli i produktit të përmirësimit dhe hartimi i raportit përkatës.
- i) Ligjësimi dhe përfshirja e produktit të përmirësimit në bazën shtetërore të të dhënave kadastrale.
- j) Njoftimi i Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë Vendore përkatëse mbi përfundimin e procesit.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë depozituar **rreth 650** kërkesa për Përmirësimin dhe Përditësimin e blloqeve kadastrale, të dërguara nga individë, drejtoritë vendore të ASHK-së dhe institucione të ndryshme. Këto kërkesa përfshijnë pasuri të cilat ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Spektori i Përmirësim/Përditësimit, aktualisht ka në trajtim **154 kërkesa** të paraqitura nga individët, drejtoritë vendore të ASHK-së dhe institucione të tjera.

Më poshtë, ju paraqesim një përmbledhje të trajtimit të kërkesave, dhe fazës në të cilën ndodhet procesi i Përmirësimit/Përditësimit, që nga krijimi i QKD-së e deri aktualisht:

- ✓ **23** kërkesa janë ligjësuar.
- ✓ **14** kërkesa në pritje të Raport-Kontrollit nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK.
- ✓ **12** kërkesa janë pezulluar për arsye të ndryshme
- ✓ Të tjerat në proces.

Pra, parashikohet edhe që gjatë vitit 2024 numri i kërkesave të **dyfishohet**. Objektivi i Sektorit të Përmirësim/Përditësimit është që të trajtojë me përparësi të gjitha kërkesat e vitit 2023 brenda një afati sa më të arsyeshëm. Synim parësor mbetet edhe trajtimi i kërkesave të ardhshme (vitit 2024), që të krijohet mundësia që procesi i Përmirësimit dhe Përditësimit të jetë në përputhje me kohën e paraqitjes së tyre. Kjo mund të arrihet nëpërmjet **zgjerimit të personelit deri në dyfishin e kapacitetit aktual**, për të qënë sa më objektiv dhe koherent në trajtimin e kërkesave.

**Spektori i Regjistrimit Fillestar**, pranë Qendrës së Kadastrës Digjitale, funksionon në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.15, datë 31.01.2022 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i cili ka si kompetencë kryerjen e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

Pra krijimin e hartës kadastrale dhe grumbullimin/arkivimin e të dhënave për këto pasuri ta paluajtshme si dhe mundësinë e përfshirjes brenda “qarkullimit civil” të pasurive të paluajtshme në këto zona informale dhe të paazhuruara.

Baza ligjore ku fokusohet e gjithë veprimtaria e këtij sektori është ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 11.01.2023 “Për rregullat e hollësishme, mënyrat dhe mjetet tekniko-hartografike për përmirësimin e regjistrimit kadastral”, ligji 20/2020 (per perfundimin e proceseve kalimtare...) si dhe Urdhri nr.1090, datë 08.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

Sektori i Sektori i Regjistrimit Fillestar ka një staf të kualifikuar prej **22 punonjësish**, prej të cilëve 20 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori, të specialiteteve **Inxhinier Hartograf (8 specialistë)** dhe **Jurist (14 specialistë)**, që kryejnë realizimin e procesit të Regjistrimit Fillestar, të organizuar në grupe që përbëhen nga 1 hartograf dhe 1-2 juristë, në bazë të numrit të kërkesave të paraqitura dhe problematikave të ndryshme.

#### **Më poshtë po ju listojmë zonat të cilat janë në proces pune**

\*Bazuar në shkresën nr.13837/7 prot,datë 02.02.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme QKD brenda vitit 2023 duhet të fillonte dhe të përfundonte procedurën e regjistrimit fillestar për këto zona kadastrale:

1. ZK 1431 Curraj i Epërm ,Bashkia Tropojë
2. ZK 2283 Krumë, Bashkia Has
3. ZK1637 Frashër, Bashkia Përmët
4. ZK2960 Pilur, Bashkia Himarë
5. ZK 3265 Sasaj, Bashkia Himarë
6. ZK 3715 Vahaj, Bashkia Peqin
7. ZK 3375 Shipskë, Bashkia Korçë
8. ZK 3507 Stanaj, Bashkia Belsh
9. ZK 1616 Fierzë, Bashkia Belsh
10. ZK1930 Hardhias, Bashkia Belsh

\*Referuar kësaj shkrese Qendra e Kadastës Digjitale ka vijuar procesin e regjistrimit fillestar për këto zona kadastrale si azhurnimin në terren, mbledhje informacioni, mbledhje dokumentash me institucionet përkatëse si dhe punimin në zyrë për finalizimin e produktit digjital.

1. ZK 3507 Stanaj, Bashkia Belsh
2. ZK 1616 Fierzë, Bashkia Belsh
3. ZK1930 Hardhias, Bashkia Belsh

\*Bazuar në mbledhjet e bëra me **Task Forcën**, gjatë diskutimit u konstatua se Qarku Shkodër, Zyra Vendore e ASHK –Shkodër ka shumë zona kadastrale të cilat nuk e kanë kaluar procedurën e regjistrimit fillestar dhe u propozua që të fillojë procesi i regjistrimit për këto dy zona kadastrale:

1. ZK 2010 Jubicë, Bashkia Malësi e Madhe
2. ZK 2047 Kalldrun, Bashkia Malesi e Madhe
3. ZK 3389 Shkjezë, Bashkia Malesi e Madhe

\*QKD po kryen vazhdimin e procesit të regjistrimit fillestar për blloqet e mbetura të zonave bregdetare bazuar në Urdhrin 1355 datë 21.05.2020 si:

1. ZK 1739 Gjilekë Blloku nr.3 ,për afishim publik gjate 2024.
2. ZK 1952 Himarë Blloku nr.2, afishim publik gjate 3- mujorit të parë.
3. ZK 2518 Lukovë Blloku nr.4, për afishim publik gjatë 3- mujorit të parë.

\*Dorëzuar zona kadastrale në Drejtorinë e Përgjithshme fazë kontrolli, pritje të afishimit publik.

-ZK 3534 Suc në Drejtorine e Pergjitheshme me shkresën Nr.535/7 datë 19.12.2023

-ZK 1739 Gjilekë ,Blloku nr.2

-ZK 2806 Nivice Blloku nr.1

\*Në pritje të ligjërimit për **ZK 1481 Dhërmi.**

\*Po vijon edhe procedura për regjistrim fillestar në zonat;

1. ZK 3241 Rrushkull ,Bashkia Durrës
2. ZK 3989 Stravec ,Bashkia Divjakë
3. ZK 8573 Lushnje –Saravë ,Bashkia Lushnje
4. ZK 2321 Kullë ,Bashkia Durrës
5. ZK 2503Lubonjë,Bashkia Korce

\*Gjithashtu QKD është duke kryer procedurën e regjistrimit fillestar për 4 zona kadastrale ku përfshihet projekti i Hidrocentralit të Skavices në bazë të Urdhrit nr.2376 datë 09.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

1. **ZK 2153 Kishavec ,Bashkia Dibër**
2. ZK 1521 Dovolani, Bashkia Dibër
3. ZK 2072 Kandër, Bashkia Dibër
4. **ZK 3717 Vasie, Bashkia Dibër**

\*QKD do vazhdojë procedurën gjatë vitit **2024** edhe për zonat që kanë mbetur pa filluar procedura gjatë vitit 2023 për shkak të kërkesave për zona të tjera kadastrale.

1. ZK 2283 Krumë, Bashkia Has
2. ZK 3265 Sasaj, Bashkia Himarë
3. ZK 3715 Vahaj, Bashkia Peqin
4. ZK 3375 Shpëskë, Bashkia Korçë.
5. ZK1637 Frashër, Bashkia Përmët
6. ZK2960 Pilur, Bashkia Himarë

\*Përsa i përket një plani pune paraprak sektori i regjistrimit fillestar ka si synim dorëzimin e fazës së parë të këtyre zonave kadastrale gjatë muajit të parë të vitit 2024:

-ZK 1616 FIERZË

-ZK 1930 HARDHIAS

-ZK 2010 JUBICË

-ZK 2047 KALLDRUN

\*Gjatë muajve në vazhdim të vitit 2024 pritet edhe përfundimi i zonave kadastrale nga regjistrimi fillestar duke qenë që ka filluar azhurnimi në terren për keto dy zona kadastrale:

-ZK 2153 KISHAVICE

-ZK 2072 KANDER

Theksojmë që gjatë vitit 2024, QKD do të bëjë kërkesë edhe për zona të tjera kadastrale bazuar në kërkesën e qytetarëve, institucioneve të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit etj. Duke analizuar planin e punës arrijmë në konkluzionin se për një realizim sa më efektiv dhe në kohë lind nevoja për specialitë të tjerë në sektor, bazuar në zonat që janë në process punimi dhe zonat që priten të punohen gjatë vitit 2024.

***“Per te arritur objektivat e vitit 2024 Sektori i Regjistrimit Fillestar ka njevoje per rritjen e numrit të specialisteve (Juriste/Hartografe) në sektor.”***

**Sektori i Verifikimit në Terren**, pranë Qendrës së Kadastrës Digjitale, funksionon në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.15, datë 31.01.2022 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i cili ka si detyrë funksionale,

- 1- Verifikimin e terrenit dhe pasqyrimin e tij në harta e punës,
- 2- Realizimin e matjeve fushore,
- 3- Në rastet e regjistrimit fillestar, janë grupet e terrenit të cilat mbledhin informacionin në terren dhe dorëzimin e këtij informacioni pranë grupeve të punës. Të njëjtin proces verifikimi, realizojnë dhe në rastin e përditësimit pjesor të blloqeve kadastrale. Është sektor mjaft strategjik dhe i domosdoshëm sa i përket procesit të regjistrimit fillestar si dhe atij të përmirësimit/përditësimit. Niveli i lartë profesional i specialistëve të këtij sektori është i padiskutueshëm.

**Sektori i Finances, Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese**, merret me menaxhimin e financave të QKD, shpenzimet operative me qëllim funksionimin e sektoreve dhe mbarevajtjen e punës, evidenca, përgatitje pasqyrave financiare si dhe përgatitjen pagave të punonjesve si dhe Menaxhimin e burimeve njerezore për QKD.

#### **IV. Transferimi i pronave nga Institucionet Qendrore tek Njësitë e Qeverisjes Vendore.**

Për vitin 2023 procesi i transferimit të Pronave në Njësitë e Vetëqeverisjes vendore është përqëndruar kryesisht vetëm për pronat prioritare për të cilat bashkitë kanë pasur investime strategjike ose interes vendor.

Lidhur me procedurat që duhet të kryenin për përditësimin e listave të inventarit për pronat e transferuara në pronësi nuk ka pasur vendimmarrje nga këshillat bashkiak për lista të plota. Gjithashtu nuk ka vijuar procesi i transferimit për ato njësi administrative të cilat nuk kanë lista përfundimtare të transferimit të pronave.

Gjatë vitit 2023 statistikat janë :

<i>Projektvendime për Vitin 2023</i>			
Statusi i Projektvendimeve	Nr. i Projektvendimeve	Nr. i pronave	Shënime
Të miratuara	11	20	
Të kthyera	14	22	Me shkresën nr. 5556, datë 24.11.2023; dhe me shkresën nr. 2199/10 datë 17.7.2023
Në pritje të miratimit nga KM	2	5	
Në proces plotësim dokumentacioni	16	138	

Në shkresën e sipërcituar 5556, datë 24.11.2023, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit nr. 20/2020 neni 39, arsyetohet se: **përditësimi i pjesshëm i listave të pronave të paluajtshme shtetërore nuk mund të zëvendësojë procesin e përditësimit të plotë të pronave të paluajtshme publike i cili është detyrim ligjor.** Në bazë të pikës, 3 të neni 35, të ligjit nr.20/2020, *transferimi rishtas i pronave të paluajtshme të shtetit të njësitë e vetqeverisjes vendore do të vijojë në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetqeverisjes vendore, vetëm pasi të jete kryer me parë përditësimi i pronës, sipas kreut IV, të ligjit 20/2020.*

Ndërsa me shkresën nr. 2199/10 datë 17.7.2023 është kthyer pa veprim transferimi i Kalasë së Vilë Bashtovës pas kundërshtimit të Ministrisë së Kulturës.

Për kërkesat e bashkive (16 praktika) në proces plotësimi, ASHK bazuar në shkresën 5556, datë 24.11.2023 ka vënë në dijeni të gjitha bashkitë që nuk do të vijojë me trajtimin e tyre por do të vijojë procedurat ligjore të përditësimit dhe transferimit vetëm nëpërmjet listave të plota ose të pjesshme.

Lidhur me projeksionin për vitin 2024 Agjencia Shtetërore e Kadastrës koordinon procesin e transferimit të pronave bazuar në vendim marrjen e Këshillave Bashkiak për këtë arsye në nuk mund të japim një projeksion mbi këtë vendimarrje të bazuar në shifra.

Me miratimin e Vendimit nr.28 VKM nr. 28, datë 27.1.2023 *“Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”*, nisur nga situata e deritanishme për të gjitha njësitë administrative duhet të fillojnë përditësimin i listës pronave për 170 njësi administrative dhe të vijojë transferimi përfundimtar për 203 njësi administrative në të gjithë vendin.

Për sa më sipër përditësimi është shprehur në njësi administrative pasi në një bashki njësitë administrative përbërëse janë në faza të ndryshme të procesit të inventarizimit dhe transferimit të pronave.

### *Situata e inventarizimit dhe transferimit*

	<i>Qarku</i>	<i>Bashki</i>	<i>Nj.A</i>	<i>Miratuar lista inventari</i>	<i>Miratuar lista paraprake</i>	<i>Miratuar lista përfundimtare</i>
1	Berat	5	25	25	19	15
2	Dibër	4	35	35	21	12
3	Durrës	3	16	16	14	9
4	Elbasan	7	50	50	28	20
5	Fier	6	42	42	33	28
6	Gjirokastër	7	32	32	25	18
7	Korçë	6	37	37	30	18
8	Kukës	3	27	27	12	5
9	Lezhë	3	21	21	15	6
10	Shkodër	5	33	30	19	9
11	Tiranë	5	29	29	29	21
12	Vlorë	7	26	25	20	9
		61	373	369	265	170

#### **V. Pronat shtetërore të Pushtetit Qendror.**

Për vitin 2023 janë dërguar 17 Projektvendime në Këshillin e Ministrave, 9 prej të cilave janë miratuar dhe 8 janë në proces.

Për 9 VKM e miratuara janë trajtuar 58 pasuri. (Kryeministria, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Kulturës).

Për 8 Projekt VKM e dërguara pritet miratimi për 77 pasuri. (Kryeministria, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sporteve)

Për më tepër detaje gjeni tabelën si më poshtë:

	Nr.	Institucioni	Nr. VKM	Date VKM	Nr. Pasurive
Projekt VKM e derguara ne KM	17				
VKM te miratuara	9	Ministria e Brendshme	285	17.05.2023	1
		Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	370	21.06.2023	4
		Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	573	11.10.2023	1
		Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	574	11.10.2023	1
		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	585	18.10.2023	1
		Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	626	08.11.2023	1
		Kryeministria	746	20.12.2023	1
		Ministria e Kultures	715	13.12.2023	43
		Kryeministria		28.12.2023	5
<b>Totali i pasurive</b>					<b>58</b>
Projekt VKM te pamiratuara	8	Ministria e Infrastruktures dhe Energjetikes			5
		Ministria e Infrastruktures dhe Energjetikes			1
		Ministria e Infrastruktures dhe Energjetikes			2
		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit			9
		Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale			27
		Kryeministria			4
		Ministria e Arsimit dhe Sporteve			25
		Ministria e Infrastruktures dhe Energjetikes			2
<b>Totali i pasurive</b>					<b>75</b>
<b>TOTALI</b>					<b>133</b>

#### - Plani për Vitin 2024.

Në lidhje me projeksionin për vitin 2024, ASHK ka iniciuar procesin e koordinimit të punës me institucionet e pushtetit qendror duke asistuar në të gjithë dinamikën e procesit të inventarizimit/përditësimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore. ASHK ka shërbyer si udhërrëfyes për institucionet në kuadër të trajnimit dhe angazhimit të strukturave përkatëse pranë çdo dikasteri në funksion të regjistrimit të pronave shtetërore. Duke parë ecurinë e deritanishme si dhe duke shpresuar në angazhimin e plotë të institucioneve, ASHK projektton një rritje të numrit të Projektvendimeve apo certifikimeve. ASHK ka qenë dhe do jetë e gatshme të asistojë këtë proces, i cili duhet thënë që është dinamik ku përfshin disa institucione. Ecuria e këtij procesi do të varet nga ndërveprimi midis vetë institucioneve dhe strukturat në varësi të tyre.

#### VI. Sekretariati Teknik i Komisionit të Objekteve të Konfiskuara pranë ASHK-së.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, është krijuar Komisioni i Objekteve të Konfiskuara, i cili, në zbatim të këtij ligji, është përgjegjës për:

- Vlerësimin dhe miratimin e programit të zhvillimit, përfshirë detajimin dhe përcaktimin e masave /detyrave/ të drejtave, të cilat synojnë zbutjen e pasojave të krijuara nga konfiskimi për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje me qëllim fitimi, në përputhje me parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Miratimit të pjesës takuese të pronarit të truallit, sipas kontratës noteriale, me qëllim zhvillimin e ligjshëm të pronës, kontratë e cila është e regjistruar në regjistrat përkatës të

- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përpara datës së konstatimit të paligjshmërisë së ndërtimit;
- miratimit proporcionalisht të detyrimit financiar të paguar nga personat e tretë në favor të subjektit ndërtues/zhvillues nëpërmjet sistemit bankar nëse bazohet në një kontratë të hartuar përpara noterit dhe të regjistruar në regjistrat përkatës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përpara datës së konstatimit të paligjshmërisë së ndërtimit;
  - përcaktimit të mënyrës së administrimit, shfrytëzimit të objekteve të konfiskuara apo pjesëve takuese të tyre;
  - përcaktimit të autoritetit shtetëror që do të marrë në përgjegjësi administrimi apo përdorim të përkohshëm objektin e konfiskuar;
  - si dhe përcaktimit të njësisë zbatuese përgjegjëse për zbatimin e masave në përmbajtje të planit të zhvillimit.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, Komisioni mbështetet nga Sekretariati Teknik i krijuar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

Komisioni i Objekteve të Konfiskuara ka zhvilluar mbledhjen e parë në datë 11.10.2023, në të cilën janë prezantuar procedurat e ndjekura nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) lidhur me objektet, për të cilat është marrë vendimi i konfiskimit, evidentimi i problematikave të hasura gjatë këtyre procedurave, si dhe ecuria e punës së Komisionit në vazhdimësi.

Në mbledhjen e parë të Komisionit, MFE ka informuar se në zbatim të VKM-së nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, janë konfiskuar me vendim të KKT **25 objekte pa leje**, të tipologjive të ndryshme. Për 10 nga këto objekte janë administruar kërkesë për parablerje, të cilat janë trajtuar, është realizuar vlerësimi i objekteve nga ekspert vlerësues. Për 3 nga këto objekte ka përfunduar procedura dhe janë lidhur kontratat, për të tjerat është proceduar me pagesën e 10%.

Gjithashtu, një çështje e rëndësishme e trajtuar në mbledhje, ka qenë edhe kërkesa e MFE për angazhim maksimal nga të gjitha institucionet e ngarkuara me ligj që të vijnë me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda muajit Tetor, për të cilat sqarojmë si me poshte:

- Në zbatim të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 66/2023, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka dërguar në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 13536/5 prot., datë 30.10.2023, projektvendimin “Për miratimin e rregullave për administrimin e Regjistrat të Objekteve të Konfiskuara...”, për të cilin, ASHK është në pritje të mendimeve me komente/sugjerime nga institucionet e linjës, nëse do ketë.
- Në zbatim të pikës 5 të nenit 11, të Ligjit 66/2023, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas shkrës nr. prot 18466 date 10.10.2023, është percjelle për dhenie mendimi projektvendimi “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Objekteve të Konfiskuara”, se ciles i është kthyer pergjigje me date 23.10.2023 sipas tones nr. prot 13536/3, ndersa me shkresen nr. prot 13536/5 date 30.11.2023, te Agjencise Shtetërore te Kadastrës, është percjelle prane Keshillit te Ministrave, për shqyrtim dhe miratim, projektvendimi “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Objekteve të Konfiskuara”.
- Në zbatim të pikës 9 të nenit 20, të Ligjit 66/2023, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas shkrës nr. prot 23701 date 26.12.2023, është percjelle për dhenie mendimi projektvendimi “Për rregullat e zhvillimit të programit të shitjes së objekteve të Konfiskuara si ndertime pa leje”, se ciles

i është kthyer pergjigje me date 28.12.2023 sipas tones nr.prot 16853, nepermjet te ciles Agjencia Shtetere e Kadastrës, ka percjelle prane Keshillit te Ministrave, dhenien e mendimit, mbi projektvendimin sa me siper cituar.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, Sekretariati Teknik pranë ASHK-së ka realizuar një takim me Kryetaren e Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, në të cilin është ngarkuar me detyrën për të marrë në dorëzim nga MFE një kopje të dokumentacionit teknik të 13 objekteve të konfiskuara, për të cilat nuk ka kërkesë për parablerje, me qëllim plotësimin e tyre me të dhëna specifike lidhur me sipërfaqet, vendndodhjen etj, duke qenë se këto objekte do të shqyrtohen në vijimësi nga Komisioni i Objekteve të Konfiskuara.

Aktualisht, Komisioni dhe Sekretariati në mbështetje të tij, janë në pritje të miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 66/2023, me qëllim vijimin e procedurave ligjore për objektet e konfiskuara.

## **VII. Sektori i çështjeve Gjyqësore.**

### **- Numri i çështjeve të fituara/të humbura sipas drejtorive/zyrave vendore për vitin 2023 dhe parashikimi për vitin 2024**

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (ASHK) si person juridik publik në varësi të Kryeministrit, është krijuar si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së duke trashëguar nga këto institucione të gjitha çështjet gjyqësore të filluara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

Përfaqësimi i ASHK-së në marrëdhënie me të tretët, realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së dhe të drejtorive/zyrave vendore të ASHK-së. Për përmbushjen e këtij qëllimi, në strukturën e Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, në Drejtorinë e Përgjithshme, është Sektor i Çështjeve Gjyqësore, i krijuar në muajin Maj 2019 (me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”). Përpos përfaqësimit të insitucionit në konfliktet gjyqësore ku ASHK është palë e paditur apo palë e tretë, ky sektor gjithashtu ka për detyrë funksionale edhe mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore, që përcillen nga drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK-së. Raportimi i këtyre të dhënave, bëhet nga drejtoritë vendore çdo muaj në përputhje me formën dhe mënyrën e raportimit në përcaktuar sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 600, datë 11.02.2021 për “Për rregullat e përfaqësimit, raportimit dhe ndërveprimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me institucionet shtetërore, në proceset gjyqësore”.

Sipas Udhëzimit të sipërcituar, raportohen nga drejtoritë vendore edhe praktikat e fituara dhe të humbura, çdo 6 muaj (2 herë në vit), përkatësit në muajin Qershor dhe Dhjetor.

Për 6-mujorin e parë të vitit 2023, numri i çështjeve të fituara/të humbura që lidhen me çështje të pronësisë sipas drejtorive vendore, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet në Tabelën Nr.1 bashkëlidhur.

### **- Plani për Vitin 2024.**

Sa i takon parashikimit të numrit të çështjeve të fituara/të humbura, është bërë një parashikim duke ju referuar numrit të çështjeve të fituara apo të humbura në shkallën e parë e që në

projeksionet tona ecuria do të jetë e njëjtë edhe në apel. Nga ana tjetër, duke qënë që ekskluziviteti i vendimmarrjes i takon Gjykatës nuk përjashtojmë mundësinë që, situata mund të ndryshojë në favor apo jo të ASHK-së. Për vitin 2024, nga 1765 çështje të regjistruara gjithsej, parashikojmë që numri i çështjeve të fituara, do të jetë 242 (rrëzuar padia në shkallë të parë) dhe numri i çështjeve të humbura do të jetë 193 (pranuar padia në shkallë të parë).

Sqarojmë se, të dhënat e raportuara janë nxjerrë nga një bazë të dhënash të mbledhura nga Sektori i Çështjeve Gjyqësore nga krijimi i këtij sektori e deri tani. Pra, jo domosdoshmërisht në vitin 2024, çështjet e përfunduara në shkallë të parë do të jenë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Administrativ/Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo, pasi është në varësi të organizimit të brendshëm të Gjykatës. Referuar informacionit të mbledhur, Gjykata Administrative e Apelit aktualisht është duke shqyrtuar çështje të regjistruara pranë kësaj gjykate në vitin 2017 (çështje të trashëguara nga ish institucionet me të cilat është krijuar ASHK-ja).

**Numri i çështjeve gjyqësore të fituara/të humbura  
Periodha Janar-Dhjetor 2023**

*Tab. 1*

<b>Drejtoria Vendore e ASHK</b>	<b>Te fituara</b>	<b>Te humbura</b>
RURALE 2	2	3
RURALE 1	49	16
VLORA	4	12
KORCA	0	1
BERAT	13	2
GJIROKASTËR	30	11
ELBASAN	16	0
KUKËS	10	2
TIRANA JUG	23	13
SARANDË	15	9
ZONAT E STIMULUARA	2	0
SHKODËR	21	14
KAMËZ-VORË	5	11
LUSHNJE	22	6
POGRADEC	8	2
DURRËS	63	13
KRUJË	6	5
KAVAJË	0	0
TIRANA VERI	47	14

KUÇOVË	0	0
FIER	16	8
DIBËR	2	1
TEPELENË	5	1
LEZHË	7	1
<b>Gjithsej</b>	<b>366</b>	<b>145</b>

*P.S: Ketu perفشihen edhe te dhenat e zyrave vendore ne varesi te drejtorisë*

### **VIII. Sektori Juridik dhe Hartimit të Legjislacionit.**

- Aktet nënligjore zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjin nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare ...”, për vitin 2023.

Në funksion të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni për kadastrën, si dhe ai për proceset kalimtare të pronësisë, Sektori Juridik dhe Hartimit të Legjislacionit, në Njësinë Juridike dhe të Kontrollit ka hartuar mbi 99 % të akteve nënligjore (projektvendime të Këshillit të Ministrave), në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Në zbatim të VKM nr.862, datë 27.12.2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do paraqiten për shqyrtim në KM për vitin 2023”, për Agjencinë Shtetërore të Kadastres ishin parashikuar për tu shqyrtuar e miratuar 5 projektakte.

- *“Për percaktimin e rregullave të hollësishme për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, cmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë falje si dhe zbritjet e përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit”*
- *“Modeli dhe rregullat e mbajtjes së regjistrimit të lejes së ndërtimit”*
- *“Percaktimi i rregullave të detajuara mbi zbatimin e procedurës së regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo premtim shitje”*
- *“Për miratimin e metodologjisë për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”*
- *“Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”*

ASHK nga këto akte ka përcjelle për shqyrtim e miratim sipas programit, 4 projektakte në Këshill të Ministrave, nga të cilat 1 është miratuar dhe 3 janë në proces shqyrtimi e miratimi ende në Këshill të Ministrave. 1 projektakt, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH” është në proces punimi brenda institucionit, Sektori i Vlerësimit të Pasurive, pasi ecuria e tij varet nga miratimi i projektaktit të metodologjisë).

Ndërkohë, gjatë vitit 2023 kanë qenë në proces shqyrtimi e miratimi në KM edhe 3 projektakte të cilat janë përcjelle nga ASHK në vitin 2022 për shqyrtim e miratim, të cilat ende janë në proces shqyrtimi në KM, për të cilat ASHK ka bërë komentet saktësimet përkatëse në lidhje me sugjerimet e institucioneve.

- Sjellim ne vemendje se ASHK, ka përcjellë për shqyrtim e miratim në KM me shkresen nr.13536/5 prot., datë 30.11.2023 edhe projektvendimin “Për miratimin e rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara, të dhënat parësore dhe dytësore të tij, subjektet e interesuara dhe niveli i aksesit.” (akt i cili nuk ka qene parashikuar ne PPAP 2023)

Në mënyre analitike, tabela e akteve nenligjore në proces dhe tabela e akteve nenligjore te ASHK paraprake te planfikuar ne PPAP 2024 te deklaruar ne KM

Aktet nënligjore të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” në proces:

Nr	Emertimi i projektaktit	Statusi
1	“Per percaktimin e rregullave te hollesishme per kalimin e te drejtes se pronesise dhe regjistrimin e pasurise se legalizuar, pagesen , cmimin favorizues, kategorite e subjekteve qe perfitojne falje si dhe zbritjet e perqindjet e pedorimit te bonove te privatizimit”	<b>PPAP 2023, 4MI</b> Miratuar me VKM nr.446, date 26.07.2023
2	"Modeli dhe rregullat e mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit"	<b>PPAP 2023, 4M2</b> <b>PPAP 2023-Përcjellë projektakti në KM për shqyrtim e miratim me shkresen nr.9083 prot., date 16.05.2023. Eshtë zhvilluar bashkërendimi me institucionet dhe ASHK ka reflektuar komentet e institucioneve dhe KM dhe i ka përcjellë zyrtarisht draftin e saktësuar me shkresen nr.9083/2 prot., date 07.12.2023. Aktualisht eshte per miratim ne KM.</b>
3	"Përcaktimi i rregullave të detajuara mbi zbatimin e procedurës së regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo premtim shitje"	<b>PPAP2023-4M3</b> Përcjellë projektakti në KM për shqyrtim e miratim me shkresen nr.9083 prot., datë 16.05.2023. Eshtë zhvilluar bashkërendimi me institucionet dhe ASHK ka reflektuar komentet e institucioneve dhe KM dhe i ka përcjellë zyrtarisht draftin e saktësuar me shkresen nr.9083/2 prot., date 07.12.2023. Aktualisht eshte per miratim ne KM.
4	Për miratimin e metodologjisë për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"	<b>PPAP 2023- 4M 3</b> Percjelle ne KM me shkresen nr.14490 prot., date 30.10.2023

		<p>Komente MD dhe MBZHU,</p> <p>ASHK beri saktësimet dhe percolli ne KM me shkresen nr.14490/1 prot., date 07.12.2023 draftin e saktësuar.</p>
5	"Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"	<p><b>PPAP 2023-4M3</b></p> <p>Ne proces brenda institucionit (Njësia e Hartografisë dhe Kadastres/Spektori i Vleresimit të Pasurive)</p>
6	"Për rregullat e hollësishme të bashkëkëndimit të punës ndërmjet ASHK dhe ATP"	<p><b>PPAP 2022 (Riplanifikuar 4M3 viti 2023)</b></p> <p>Projektvendimi është përcjellë nga ASHK për shqyrtim në KM me shkresën nr.1079 prot., datë 19.01.2022 dhe nr.10787 prot, date 24.05.2022. Sugjerime ATP, MD, AVSH.</p> <p>ASHK percjelle ne KM komentet lidhur me sugjerimet e MD, AVSH dhe ATP.</p> <p>(mosdakortesi midis ATP dhe ASHK per disa pika. Lene per takim ATP dhe ASHK )</p> <p>U zhvillua takim midis ASHK dhe ATP.</p> <p>ASHK percolli pas saktësimeve draftin me shkresen nr. nr.12866/1 prot., date 07.11.2023, ne ATP, dijeni KM dhe MD.</p>
7	"Për procedurat e hollësishme që zbatohen për kalimin e pronësisë dhe modeli i aktit të kalimit të pronësisë të trojeve shtetërore në përdorim"	<p><b>PPAP2022 (Riplanifikuar 4M2 viti 2023)</b></p> <p>Projektvendimi është përcjellë nga ASHK për shqyrtim në KM me shkresën nr.8253 prot., datë 15.04.2022. Komente MD, MFE, AVSH.</p>

		<p>ASHK ka bere sakesimet dhe komentet lidhur me to dhe i ka percjelle ne KM</p> <p>(mbetur projektakti ne pritje deri ne daljen e ligjit nr.18/2023 "Per perfundimin e procesit te privatizimit te objekteve te ish ndermarrjeve bujqesore".</p> <p>ASHK pas miratimit te ligjit ka percjelle me email ne KM, projektaktin me sakesimet perkatese pas hyrjes ne fuqi te ligjit te sipercituar.</p> <p>Nga KM eshte percjelle per bashkerendim tek MD. MFE, MBZHU, te cilat kane bere sugjerimet perkatese.</p> <p>ASHK ka percjelle me email ne KM komentet/sugjerimet perkatese mbi sugjerimet e MD, MFE dhe MBZHU. KM ka percjelle per bashkrendim tek MD sakesimet e bera nga ASHK.</p> <p>Mbyllur bashkrendimi me institucionet, ASHK ka percjelle perfundimisht elektronikisht dhe zyrtarisht ne KM draftin final me shkresen nr.13029 prot, date 20.09.2023</p> <p><b>Ka bere komente KM, per te cilat ASHK ka bere komentet/sakesimet perkatese dhe i ka percjelle me email ne KM</b></p>
8	<p>"Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi</p>	<p><b>PPAP 2022 ( Riplanifikuar 4M2 viti 2023)</b></p> <p>Percjelle me KM per shqyrtim me shkresen nr.19555 prot., date 28.10.2022. KM percjelle per mendim MD, Dhoma e Notereve dhe Permbauesve.</p> <p>Komente MD dhe Dhoma Kombetare e Noterise.ASHK ka percjelle</p>

		<p>komentet/saktesimet ne lidhje me komente e MD dhe DHKN.</p> <p><b>KM lene per bashkerendim me takim MD dhe ASHK.</b></p> <p><b>Ripercjelle projektakti pas tatkimit me MD me nr.19555/1 date 12.10.2023.</b></p> <p><b>Ripercjelle akti per bashkrendim MD dhe Avokatures se Shtetit. Sugjerime MD per te cilat ASHK ka bere komentet perkatese dhe i ka percjelle ne KM . Avokatura e shtetit eshte shprehur dakort per projektaktin.</b></p>
9	<p>“Për miratimin e rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara, të dhënat parësore dhe dytësore të tij, subjektet e interesuara dhe niveli i aksesit”</p>	<p>Përcjellë në KM me shkresen nr.13536/5 datë 30.11.2023 nga ASHK për shqyrtim e miratim. Në proces mendimi tek institucionet.</p>

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministri....

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për rregullat e hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet ASHK-së dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronës	Projekt-vendim	ZV/Kryeministri	I	Në funksion të ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", nen 57, pika 3.	Përcaktimi i rregullave të bashkërendimit të veprimtarisë midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronës	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Jo/ ka karakter teknik

2	Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen së çmimeve të tokës në RSH	Projektvendi m	ZV/Kryemistri	I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 "Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k.	Përcakton metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme(tokës) në RSH, në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Po, ndikim ekonomik dhe social
3	Per miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH	Projektvendi m	ZV/Kryemistri	II	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 "Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k.	Përcaktojë hartën e vlerës së tokës në RSH (pasurive të paluajtshme truall, tokë bujqësore, pyll, livadh, kullote), në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Po ndikim financiar dhe social
4	Për përcaktimin e elementeve formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi	Projektvendi m	ZV/Kryemistri	I	Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën, neni 71, germa b).	Përcaktimi i rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Ashk gjatë verifikimit të regjistrimit të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative të aplikuara për regjistrim	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Jo/ ka karakter teknik

5	Për përcaktimin e procedurave të hollësishme dhe modeli i aktit të kalimit të pronësi të truallit shtetëror në përdorim	Projektvendim	ZV/Kryeministri	I	Në funksion të ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", neni 63, pika 4.	Përcaktimi i procedurave dhe modeli i aktit për kalimin e pronësisë së trojeve shtetërore në përdorim	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjise ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Po/ ndikim social
6	Për disa ndryshime në VKM nr.1179, datë 24.12.2020 "Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave"	Projektvendim	ZV/Kryeministri	I	Në funksion të ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 "Per Kadastrën"	Të dhenat, aksesesi dhe subjektet që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin e lejes së ndertimit	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjise ndersektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	Jo/ ka karakter teknik

7	Për miratimin e rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara, të dhënat parësore dhe detyrësore të tij, subjektet e interesuara dhe niveli i aksesit	Projekvendim	ZV/Kryeministri	I	Në funksion të zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.66/2023 " Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtimet pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara"	Miratimi rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Siguria e pronës" (faqe 36-37)	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjise Ndersektoriale " Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo ka karakter teknik
---	---	--------------	-----------------	---	--	--	----	---	--	-----------------------

## IX. Buxheti dhe menaxhimit financiar.

Të dhënat për analizën e veprimtarisë financiare të ASHK për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë të dhëna paraprake – jo përfundimtare.

### • **Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të veta buxhetore (Të Ardhurat dhe Shpenzimet paraprake) për vitin 2023.**

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar bën menaxhimin dhe monitorimin periodik të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së.

Në përmbushje të detyrimit ligjor përgatiten periodikisht, çdo muaj, evidencat ekonomiko-financiare (të ardhurave dhe shpenzimeve), mbi:

#### • **SHËRBIMET**

Numri i shërbimeve nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme (paraprake) për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është si më poshtë:

Njësia aktuale e matjes së nivelit të punës në sistemin e regjistrimit është “shërbimi”. Në këtë kontekst një “shërbim” është çdo transaksion që ndodh në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kur kërkohet një kopje e kartelës, një kërkesë për lëshimin e çertifikatës, një kërkesë për regjistrimin e një dokumenti apo kërkesa për shërbime të tjera, ndër 76 shërbimet e ndryshme që ofron ASHK.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023 numri i shërbimeve është **1,135,932** dhe është realizuar 108% krahasuar me planin.

Në mënyrë tabelare paraqitet si më poshtë:

Numri i shërbimeve të arkëtuara në ASHK Janar – Dhjetor 2023		
	Plani	Fakti
<b>Total</b>	<b>1,050,000</b>	<b>1,135,932</b>

Shërbimet të cilat zenë peshën specifike më të madhe janë:

- Lëshim certificate pronësie 19 %
- Lëshim fragment harte kadastrale 19,7%
- Lëshim kopje karteles 27.2%

#### • **TË ARDHURAT**

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet dhe legalizimet e pasurive të paluajtshme.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2023 të ardhurat (paraprake) janë si më poshtë:

Të ardhurat në total për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë realizuar në masën **2,755,273,799** lekë. Kjo krahasuar me planin është realizuar 115.8%, ose 375,273,799 lekë më shumë. Të ardhurat e realizuara nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme (ofrimi i shërbimeve kadastrale) janë realizuar në masën **2,223,438,955** lekë ose 123.5%, ose 423,438,955 lekë më shumë, dhe të ardhurat e realizuara nga legalizimi (parcelë ndërtimore dhe të tjera) janë realizuar në masën **531,834,844** lekë, ose 91.6%, ose 48,165,156 lekë më pak në krahasim me planin, të cilat janë paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Në Lekë

<b>Të ardhurat e ASHK në total (regjistrimi &amp; legalizimi paraprake)</b>		
<b>Periudha</b>	<b>Plani Janar – Dhjetor 2023</b>	<b>Fakti Janar – Dhjetor 2023</b>
	2,380,000,000	2,755,273,799

<b>Të ardhurat e ASHK në total nga regjistrimi (paraprake)</b>		
<b>Periudha</b>	<b>Plani Janar – Dhjetor 2023</b>	<b>Fakti Janar – Dhjetor 2023</b>
	1,800,000,000	2,223,438,955

<b>Të ardhurat e ASHK në total nga legalizimi (paraprake)</b>		
<b>Periudha</b>	<b>Plani Janar – Dhjetor 2023</b>	<b>Fakti Janar – Dhjetor 2023</b>
	580,000,000	531,834,844

- **Të ardhurat nga Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për periudhën Janar-Dhjetor 2023 (paraprake)**

Në zbatim të Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ardhurat që ASHK vjel si agjent tatimor për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, derdhen respektivisht:

- 97 % për buxhetin e Bashkisë apo Njesise Administrative, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.
- 3% në buxhetin përkatës të Drejtorive Vendore të ASHK-së, në llogaritë respektive jobuxhetore.

Të ardhurat totale nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për periudhën Janar - Dhjetor 2023 (3%) janë 19,555,710 lekë.

- **Në të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 nga shërbimet nuk përfshihen:**

- Të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e shtetit si agjent tatimor për:
  - Tatimin mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë (15%).
- Të ardhurat që ASHK vjel nga legalizimi
  - Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat Turistike për ATP-në (pëkatësisht në masën 70% dhe 50% )

Në mënyrë tabelare të ardhurat e realizuara për tatimin e kalimit të pronësisë dhe për ATP paraqiten si më poshtë:

Në lekë			
<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera 15%</b>	<b>Vlera ATP</b>
1	Tatimi mbi te ardhurat nga kalimi i pronësisë 15%	5,371,484,460	
2	Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat turistike për ATP-në		797,331,064

- **SHPENZIMET**

**Shpenzimet e përlogaritura (paraprake)**

Në mbështetje të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, në bazë të Urdhërit nr.84, datë 02.05.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimeve “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Njësitë shpenzuese të ASHK (Drejtoria e Përgjithshme-DP dhe Drejtoritë Vendore-DV) vazhdojnë veprimtarinë e tyre në bazë të të ardhurave të realizuara ku kryejnë shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, mallra, shërbime dhe investime sipas buxhetit të disponueshëm të planifikuar për periudhën Janar - Dhjetor 2023

**Realizimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, fond të vecantë, shpenzime operative dhe investime për cdo njësi shpenzuese rezulton si më poshtë për periudhën Janar-Dhjetor 2023 (paraprake)**

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	Realizimi %
1	Paga (zëri 600)	2,445,797,394	2,078,927,785	85%
2	Sigurime shoqërore (zëri 601)	407,354,099	346,250,984	85%
3	Fondi veçantë (zëri 606)	86,171,685	19,919,764	23%
4	Shpenzime operative (zëri 602)	567,913,028	482,726,074	85%
5	Investime të trupëzuara (zëri 230)	643,397,990	514,256,009	80%
6	Investime të trupëzuara (zëri 231)	1,329,918,804	523,778,149	39%
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>5,480,553,000</b>	<b>3,965,858,766</b>	<b>72%</b>

Realizimi i shpenzimeve në masën 72% ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të zërit të investimeve të trupëzuara për efekt të mos përfundimit të rikonstruksionit të Godinës të ASHK në rrugën “Jordan Misja”.

Për mbulimin e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2023 Drejtoritë Vendore kanë përdorur të ardhurat e veta të realizuara nga shërbimet e regjistrimit dhe nga legalizimi. Në të ardhurat e tyre përfshihen dhe të ardhurat e realizuara nga parcela ndërtimore, pjesa që i takon institucionit.

- **FONDI REZERVË**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 218 datë 20.03.2013 “Për miratimin e kufijve dhe kriteve të përdorimit të fondit rezervë të ish Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për vitin 2022 nuk u planifikua Fond rezervë, meqenëse Fondi rezervë i krijuar për vitet 2013, 2014 dhe 2015 i cili kap vlerën në total 104.700 mijë lekë nuk është përdorur. Në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ky fond rezervë i akumuluar trashëgohet dhe mund të përdoret në rast nevojë për mbulimin e dëmshpërblimeve.

**BUXHETI 2024 (Të Ardhurat dhe Shpenzime e planifikuara për vitin 2024)**

Hartimi i Buxhetit të vitit 2024 të ASHK-së mbështetet në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Ligjin 111/2018 “Për Kadastrën,”i ndryshuar

**Buxheti i ASHK-së i planifikuar për vitin 2024 është si më poshtë:**

Në 000/leke

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Buxheti i planifikuar Janar-Dhjetor 2024</b>
<b>I</b>	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>4,875,659</b>
1	Të ardhura nga shërbimet	2,210,287
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000
3	Të ardhura të tjera	200,000
4	Fondi rezerve	104,700
5	Fonde që trashëgohen nga viti 2023	2,060,672
I-1	Fonde te transferuara nga buxheti i shtetit	282,671
<b>II</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>4,857,690</b>
<b>I</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>2,755,447</b>
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1,747,455
2	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjesit në organikë	290,450
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	411,210
4	Kontribute për Sigurime Shoqerore për punonjësit me kontratë	68,672
5	Fondi i vecantë i pagave	87,373
6	Paga dhe sigurime per punonjësit e QKD 6/mujori i dytë 2024	150,287
<b>2</b>	<b>Shpenzime operative</b>	<b>652,687</b>
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	594,946
2	Shpenzime operative QKD	57,741
<b>III</b>	<b>Transferta</b>	<b>282,671</b>
1	Transferte per Qendren e Kadastres Dixhitale	282,671
<b>3</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,344,856</b>
<b>a</b>	<b>Investime kapitale të patrupëzuara</b>	<b>656,926</b>
2	Shpenzime për investime të patrupëzuara+ blerje projektesh	656,926
<b>b</b>	<b>Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstruksion +Infrastruktura IT)</b>	<b>687,930</b>
1	Rikonstruksione (Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore+Kukës etj)	518,330
2	Blerje paisje elektronike+GNSS	119,600
3	Orendi	50,000
<b>4</b>	<b>Fondi Rezervë</b>	<b>104,700</b>
1	Fondi Rezervë	104,700
	<b>TË ARDHURA (-) SHPENZIME(te ardhura te pashperndara)</b>	<b>17,970</b>
	<b>TË ARDHURA (-) SHPENZIME nga Fondet e buxhetit te shtetit</b>	

## **X. Amendimi i Marrëveshjes së Përbashkët ASHK-DHKN për shërbimet kadastrale.**

Agjencia Shtetërore e Kadastrës në përputhje me gjurmën e), të nenit 8 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, drejtuar ju si organi kompetent në zbatim të dispozitës ligjore të sipërcituar, ka paraqetur propozimin për miratim të draft Aneksit 1/1 “Për disa ndryshime në protokollin teknik të ndërveprimit ASHK-NISA(Aneksi 1) të marrëveshjes së bashkëpunimit nr.185 prot; nr.2729 prot; datë 08.01.2020, të lidhur midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve, i cili me Vendim të Këshillit Drejtues nr.8 date 23.11.2023 është miratuar dhe në zbatim të këtij vendimi është lidhur Akt marrëveshja me Dhomën Kombëtare të Noterëve nr.prot 15614/2 dhe date 30.11.2023 .

Agjencia Shtetërore e Kadastrës në kuadër të bashkëpunimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve kadastrale, ka nënshkruar marrëveshjen me Dhomën Kombëtare të Noterëve me nr.185 prot., datë 08.01.2020, me qëllim krijimin e lehtësirave të ndërsjellta për realizimin e një shërbimi publik sa më profesional dhe efikas, për sa i përket shërbimeve kadastrale. Ky bashkëpunim ka qenë i vazhdueshëm dhe gjithmonë në nivele të kënaqshme, duke u konkretizuar në vijimësi edhe me nënshkrimin e protokollit teknik të ndërveprimit ASHK-NISA, nëpërmjet të cilit është konkretizuar dhe mënyra e ndërveprimit elektronik, rregullat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave online të noterëve në sistemin elektronik të ASHK-së(ALBSCAD).

Në vijim, nga zbatimi në praktikë i këtij protokollit nga ana e noterëve për ta zbatuar sa më saktë dhe në mënyrë sa më korrekte këtë protokoll, në përputhje me parashikimet për mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit dhe brenda afateve ligjore të vendosura për trajtimin e shërbimeve kadastrale që ofrohen në mënyrë standarte/ të përshpejtuar, nga ana e Dhomës Kombëtare të Noterëve janë paraqitur propozime për saktësime të disa pikave të protokollit teknik, në mënyrë që të gjejë zbatim në mënyrë sa më efektive në praktikë ndërveprimi elektronik ndërmjet sistemit elektronik të ASHK dhe NISES, për realizimin efektiv të kërkesave për shërbime kadastrale, konkretisht saktësime në gjurmën “B”(paragrafi dhe 7 ), të cilat konsistojnë sa vijon:

**Së pari**, Mbi mënyrën sesi vepron ASHK për trajtimin e kërkesës për shërbime kadastrale dhe dokumentacionit të nënshkruar elektronikisht nga noteri (në përputhje me parashikimet e nenit 35 të ligjit “Për Noterinë”, ligjit nr.10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” dhe Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.7, datë 07.01.2021 “ Për miratimin e rregullave në lidhje me kërkesat për krijimin dhe përdorimin e dokumentave elektronikë noterialë), që konsistojnë në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur sipas afateve të parashikuara në vendimin e Këshillit Drejtues të ASHK-se dhe proceduralisht sesi vepron kur dokumentacioni është në përputhje me ligjin, apo kur ka pasaktësi/mungesa.

**Së dyti**, saktësimin e afatit për dorëzimin e dokumentacionit nga ana e noterëve (nëpërmjet protokollit), për shërbimet kadastrale standarte për afatin kohor jo më vonë se 10 ditë dhe për shërbimet kadastrale që ofrohen në mënyrë të përshpejtuar brenda ditës kjo në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe vendimit të Këshillit Drejtues të ASHK

nr.15, datë 30.09.2022 “Për miratimin e listës së shërbimeve kadastrale që mund të ofrohen në mënyrë të përshpejtuar, tarifave të diferencuara dhe afateve të trajtimit”.

Nëpërmjet miratimit të këtij Amendimi synohet që të rritet bashkëveprimi midis ASHK dhe noterëve, duke u përmirësuar cilësia në ofrimin e shërbimeve lidhur me kërkesat e noterëve për shërbime kadastrale dhe të rritet efektiviteti i përdorimit të protokollit teknik të ndërveprimit ASHK-NISA, si dhe ofrimi i shërbimeve kadastrale standarte/të përshpejtuara ndaj noterëve nga ana e ASHK, të realizohet brenda afteve kohore të parashikuara dhe me cilësi.

## **XI. Riinxhinierizimi Sistemit**

Per here te pare ne 32 vite, duke pasur thellesisht ne konsiderate sa delikate ka qene ceshtja e pronës ne Shqipëri, me nje vullnet dhe deshire per te cberë mekanizmat korruptive, te ngritura ne system nder vite, u mor nje vendim transformues dhe reformues I quajtur **Riinxhinierizim** i sistemit kadastral, i cili mori jete me date 3 korrik 2023.

Po kush ishin arsyet qe cuan ne nje vendimmarrje te tille?Me poshte do te referojme disa nga arsyet madhore qe ndikuan ne marrjen persiper dhe implementimin e kesaj reforme, dhe ketij ndryshimi thelbesor qe ju be sistemit te ofrimit te sherbimeve kadastrale qe ofron ASHK.

### **1. Aksesim i arkivave në mënyrë të pakontrolluar**

Gjatë 30 viteve të fundit, arkiva e ASHK është matur me metër linear të dokumenteve. Ajo është aksesuar nga specialistët pa kriter, pa gjurmë, duke shkaktuar kaos dhe konfuzion. Zyrat ishin të mbushura deri në prag me dosje, thua se dokumentet riprodhoheshin me njëri tjetrin. Përpjekjet për të digjitalizuar arkivat e pronave zgjatën për vite, por problemet e saktësisë së të dhënave vazhdonin dilnin në sipërfaqe.

Por tani, kemi vendosur të kthejmë faqen e kësaj historie duke i dhënë fund këtij kalvari. Riinxhinierizimi ka për qëllim të standardizojë aksesin në dokumentacionin e pronës, si dhe ruajtjen e dokumenteve me teknologjinë e blockchain. Me ndihmën e standardeve ndërkombëtare ISO për arkivat dhe menaxhimin e dokumenteve, synohet të garantohet që arkivat të jenë të qëndrueshme, të besueshme dhe të aksesueshme.

### **2. Përdorimi i vulave të Institucionit në mënyrë të pakoordinuar dhe pa kriter**

Problematikave të trashëguara prej vitesh nga mbivendosja e pronave, i janë shtuar edhe problematikat e sistemeve dhe regjistrave të keqadministruara të pronës nga zyrat që administrojnë regjistrin kadastral.

Eshtë konstatuar një fenomen, disa persona kanë pronën e tyre në regjistër, dhe disa të tjerë në sisteme. Ky fakt përveçse tregon një konfuzion se kush është regjistri zyrtar kadastral në kuptim të ligjit, krijon dhe hapësira për abuzime me pronat, fakte këto që janë evidentuar ndër vite nga organet ligjzbatuese që kontrollojnë në baze të ligjit veprimtarinë e ASHK.

Sot ASHK ka eliminuar plotësisht vulat fizike, të cilat për 30 vite radhazi kanë dëmtuar një nga shtyllat kryesore të ekonomisë, Pronën private por edhe atë publike.

Sot në ASHK, vulat e njoma janë zëvendësuar me vulat digjitale, dhe ndryshimi thelbësor është se me vulën dhe nënshkrimin digjital, nuk funksionon më data e mëparshme, nuk funksionon më ndërrimi i fletës së regjistrit. Sot cdo punonjes mban përgjegjësi para ligjit dhe mbi të gjitha, ASHK si institucioni përgjegjes për ceshtjet e pronësive mban përgjegjësi para qytetarit.

### **3. Radha**

Riinxhinierizimi ka implementuar për here të parë konceptin first in – first out, që do të thotë i pari në aplikim i pari në shërbim. Sistemi i ri nuk i jep aksesin punonjesit të ASHK të përzgjedhë në mënyrë selektive kërkesat e qytetarëve/subjekteve private dhe publike për dhenien e shërbimeve kadastrale, sistemi në shpërndan kërkesat sipas algoritmit me konceptin first in – first out ku shërbimi jepet subjektit që ka aplikuar I pari në kohë.

Organizimi i trajtimit të kërkesave për dhenien e shërbimeve kadastrale në sistemin e vjetër funksiononte duke u shpërndarë në mënyrë manuale me vullnetin e eprorit në specialistet e DVASHK-se në juridiksionin e se ciles ndodhej prona duke krijuar hapësira për abuzime, korrupsion ndikim të paligjshëm të eprorit dhe të tremeve mbi specialistet të cilët trajtonin kërkesen.

Të gjitha kërkesat për dhenie shërbimi kadastral për zonat kadastrale të caktuar jepeshin për trajtim vetëm një grupi të identifikuar (jurist-hartograf) duke krijuar një monopol në vendimarrje për ato zone kadastrale.

Sot, nuk ka kufizime territoriale, e cila nenkupton që specialisti që trajton një kërkesë të çfarëdoshme me objekt dhënie shërbimi kadastral nuk i përket drejtorisë vendore, por është specialist I ASHK i një DVASHK-je të çfarëdoshme të cilin algoritmi I sistemit të ri e përzgjedh në mënyrë rastësore dhe anonime, ku çdo pjesëtar I procesit e ka të pamundur identifikimin e pjestareve të tjerë në këtë proces duke pasur për qëllim unifikimin e procedurave në proceset kadastrale të pronësive specialisti I çdo DVASHK-je ka aftësinë të vlerësojë njësoj aktet e fitimit të pronësive për një pronë specifike në mënyrë të unifikuar për të gjithë territorin e RSH, pavarësisht se kujt drejtorie I përket ky specialist dhe vendodhjes së pronësive

### **4. Mbyllja e sporteve fizike**

Një nga hapat e marra në reformën në ASHK me riinxhinierizimin e procedurave administrative ishte mbyllja e fundimtare e sporteve fizike dhe kontaktit fizik të ASHK-se me qytetarin dhe orientimin e dhenies së shërbimit nga ASHK vetëm në rrugë elektronike, kjo si implementim I politikave të qeverisë shqiptare drejt teknologjisë të informacionit dhe digjitalizimit të shërbimeve që ofron administrata publike me qëllim minimizimin e burokracive dhenien e shërbimit në kohë reale, aksesin e paleve të treta Brenda kuadrit ligjor dhe sigurisht e fundit dhe me e rëndësishmja të minimizimit deri në suprimim të mitmarrjes dhe korrupsionit një ndër synimet kryesore të qeverisë shqiptare si një nga kërkesat kryesore për integrimin e vendit në Bashkimin Europian.

### **5. Riinxhinierizim**

Riinxhinierizimi është fjalë e madhe dhe tepër delikate, por në një kohë të shkurtër, ASHK jo vetëm që përmirësoi të gjitha proceset, por i zbaton ato tashmë.. Vendimet do të merren në mënyrë rastësore dhe digjitale. Shef zone do të jetë digjital, ndërsa specialist që trajton

praktikën në mënyrë të pidentifikueshme, i cili në çdo ndërhyrje dhe aksesim të ligjshëm mbi pronën e një qytetari, ky i fundit do të njoftohet menjëherë në e-Albania.. Veprimet e kryera nga specialistet e DVASHK do të monitorohen në kohë reale, si dhe do të jenë nën monitorimin e vazhdueshëm të struktures përgjegjëse për monitorimin e proceseve kadastrale pranë Drejtorise së Përgjithshme të Kadastrës e cila ka si detyrë monitorimin e performances në dhenien e shërbimeve kadastrale si dhe unifikimin e procedurave Brenda kuadrit ligjor në DVASHK. Reforma e rinxhinierizimit nga ASHK është e certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015, ISO/IEC 27001:2013 dhe ISO 37001:2016. Këto standarde garantojnë aspektet kyçe të menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe integritetit, të cilat janë thelbësore për funksionimin dhe besueshmërinë e një agjencie shtetërore si Agjencia e Kadastrës. Ky është një hap shumë i rëndësishëm drejt integritetit në BE.

## **XI. Problematika të Konstatuara.**

Problematikat kanë kryesisht të bëjnë me bashkërendimin institucional në zbatim të Ligjit nr.20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Në këtë drejtim, rezulton sa vijon:

- Zgjatja e proceseve gjyqësore të ngritura pranë gjykatave nga prefektët për pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” ka sjelle problematika për vijimin e procedurave të mëtejshme të trajtimit të këtyre pasurive dhe sigurisë juridike të tyre në qarkullimin civil.
- Mungesa e konfirmimit të dokumentacioneve të pronësisë lëshuar nga institucionet kompetente përpara vitit 1997(leje ndërtimi, dokumentacion privatizimi, etj.) ka sjelle pengesa në disa DVASHK, mbi regjistrimin e pasurive të subjekteve në regjistrat kadastral, apo certifikimin e këtyre pasurive.
- Mospërcjellja nga ana e institucioneve të ndryshme e dokumentacionit hartografik, bashkëlidhur akteve për regjistrim apo shqyrtim në ASHK në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” , jo sipas formatit zyrtar të miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020 “ Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, krijon vonesa dhe problematika në pasqyrimin në hartën kadastrale të këtyre akteve/pasurive.
- Mosparaqitja e kërkesave për informacion dhe dokumentacion nga ana e institucioneve të ndryshme në rrugë digjitale, (portalin “ASHK për institucionet”) dhe mospagesa e tarifave për këto shërbime kadastrale prej tyre në përputhje me parashikimet e VKM nr.389, date 13.05.2020 “ Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”. (duke krijuar detyrime financiare të pashlyera të prapambetura në favor të ASHK).

## **XII. Synimet për Vitin 2024 në fushën e Digjitalizimit.**

**- Sigurimin e ndërlidhjes me sistemin e Fiskalizimit për ASHK  
(implementuar në 2023 – projeksioni për zbatim në 2024)**

Përmes këtij projekti synohet të realizohet përbushja e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar dhe aktet nën-ligjore të nxjerra për zbatimin e tij.

Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë të gjitha nevojat e institucioneve në zbatim të legjislacionit aktual.

Procesi i fiskalizimit do të thotë që faturat e lëshuara, do të regjistrohen në Administratën Tatimore.

Fiskalizimi i faturave do të kryhet nëpërmjet shërbimit të fiskalizimit që është përgjegjës për komunikimin e tatimpaguesve me Administratën Tatimore, përpunimin e mesazheve të pranuar nga Administrata Tatimore.

Në momentin e kryerjes së Aplikimit, në sistemin Multifunksional duhet të kryhen zhvillimet e nevojshme në mënyrë që në momentin e gjenerimit të faturës për aplikantin, fatura të regjistrohet drejt në Administratën Tatimore. Duke qenë se jodomosdoshmërisht faturat e gjeneruara nga ASHK paguhen në momentin e aplikimit për shërbimin e kërkuar, kjo faturë do të regjistrohet si faturë porosi. Çdo faturë e lëshuar në momentin e aplikimit duhet të ketë si metodë pagese të shënuar “porosi” dhe titulli në faturë duhet të jetë “Faturë tatimore/porosi”. Kjo faturë do të fiskalizohet për t’iu referuar më tej gjatë procesit të kryerjes së pagesës nga aplikanti.

Në momentin e kryerjes së pagesës së shërbimit, ASHK do të dërgojë nëpërmjet sistemit Multifunksional një faturë përmbledhëse dhe do ta fiskalizojë atë. Fatura përmbledhëse duhet të përmbajë si referencë dhe të përfshira në të, faturën e mëparshme të lëshuar dhe të fiskalizuar (pra NSLF-në). Vetëm Fatura përmbledhëse e fiskalizuar, do të regjistrohet në librin e shitjeve të tatimpaguesit dhe do të merret në konsideratë. Vetëm në këtë moment, faturat porosi të lidhura me faturën përmbledhëse nuk merren më në konsideratë për llogaritje të qarkullimit. Por, çdo faturë/porosi e veçantë dhe fatura përmbledhëse duhet detyrimisht të fiskalizohen në momentin e lëshimit.

Zgjidhja veç të tjerash duhet të ofrojë dhe:

- Informacion të shpejtë mbi veprimtarinë e secilës Drejtori Vendore.
- Raporte përmbledhëse për të gjithë institucionin.
- Monitorimin e veprimeve të regjistruara nga Drejtoritë Vendore.
- Dashbordin me raportet në formë grafike dhe raporte statistikore.

**- Moduli i monitorimit të riskut.  
(implementuar në 2023 – projeksioni për zbatim në 2024)**

Ky projekt synon ndërtimin e një sistemi elektronik inteligjent i cili do të ketë si funksion studimin e sjelljes së përdoruesve në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme dhe identifikimin e rasteve korruptive. Në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë të njohura veprimet që çojnë në tjetërsim të pronës dhe akses të paautorizuar në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme. Ky sistem do të ketë në përbërje të tij një listë të paracaktuar të veprimeve të paligjshme që mund të kryhen me pronat dhe pronarët, dhe do të mund të kryejë analiza të hollësishme të veprimeve të përdoruesve që kanë akses në këtë informacion.

Në varësi të sjelljes, sistemi do të dërgojë push notification në strukturat përkatëse. Strukturat në vetvete, nuk do të kenë mundësi të ndryshojnë statusin e alertimit por vetëm të vendosin koment justifikues. Kushdo që të vijë më pas në atë strukturë apo një specialist tjetër auditi, do të ketë mundësi të monitorojë sjelljen e përdoruesit gjatë gjithë kohës që ai është përdorues sistemi si dhe evolin e riskut të korrupsionit.

Në këtë mënyrë, mund të menaxhohet fare mirë ligjshmëria e veprimeve mbi pronat të kryera nga nëpunësit e Zyrate të Kadastrës, duke ulur kështu ndjeshëm korrupsionin. Sistemi do të monitorojë veprimet e përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm në regjistrin e pronave, përfshirë këtu dhe ndërveprimet me sistemet e tjera.

#### **- Teknologjia Blockchain.**

**(implementuar në 2023 – projeksioni për zbatim në 2024)**

Janë bërë tashmë 30 vjet që të dhënat digjitalizohen, dhe çdo herë që nevojitet një vërtetim për të njëjtën pronë, ky proces kalon përmes një varg të gjatë dhe të lodhshëm verifikimesh në ASHK. Ka raste kur njerëzit kanë hequr dorë nga shitja e pasurisë së tyre vetëm për shkak të tejjzgjatjes së procesit të rifreskimit të dokumenteve të pasurisë, i cili mund të zgjasë për muaj të tërë. Por, falë teknologjisë blockchain, jo vetëm që regjistrimi i pronës do të jetë përfundimtar, por do të ruhet edhe e gjithë historia e çdo specialisti që ka firmosur dhe arsyen e firmosjes. Nëse një pasuri ka të gjitha transaksionet e saj të regjistruara dhe të digjitalizuara në teknologjinë blockchain, qytetarët do të jenë në gjendje të marrin një kopje të re të dokumenteve të pronës në kohë reale, drejtpërdrejt nga platforma e-albania. Çdo transaksion në sistem bazohet nga dokumentet e origjinës, të cilët janë të pasqyruar në arkiv. Shumica e ndërhyrjeve dhe manipulimeve në lidhje me pronën, kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me ndërhyrjen në arkivën digjitale. Ndërhyrjet mund të bëhen drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave ose përmes sistemeve. Kalimi i arkivës në teknologjinë blockchain do të garantojë përfundimisht vulosjen digjitale tashmë jo vetëm të regjistrin të pronave por edhe të dokumenteve të arkivës digjitale (origininën e pronës).

#### **- Moduli eProna**

**(implementuar në 2023 – projeksioni për zbatim në 2024)**

Duke qenë se saktësia e informacionit pranë ASHK mbetet ende një problematikë e pazgjidhur, sistemi e-prona do të shërbejë si një mjet, nëpërmjet të cilit pronarët do mund të vetdeklarojnë të dhënat e pronës së tyre.

Për çdo dokument që del nga ASHK në ditë, menjëherë pasi firmoset dokumenti me firmë elektronike nga titullari, të gjitha transaksionet e kësaj prone ruhen në një bazë të të dhënave me teknologji blockchain për të bërë të pamundur ndërhyrjen në çfarëdo formë në transaksione. Duke qenë se në rang Shqipërie kemi rreth 2500 aplikime në ditë, do të rregullonim në mënyrë të përhershme dhe të pakundërshtueshme 650.000 prona në vit. Këto prona do të ishin prona ku ka më shumë transaksione.

Pra qytetari aplikon, nëse prona është e konfirmuar (konfirmuar të paktën një herë me firmë e vulë digjitale pasi është implementuar teknologjia blockchain), atëherë ai e merr titullin e pronësisë në mënyrë të menjëhershme në shërbim nivel 4 ne e-albania. Nëse prona është e regjistruar por jo e certifikuar, atëherë specialistët e ASHK, do të kryejnë procedurat rutine (ato

që kryejnë sot), për t'i kthyer përgjigje qytetarit dhe konfirmuar pronën në këtë mënyrë. Nëse prona për të cilën aplikon qytetari nuk është fare në sistem, atëherë qytetari do të ngarkojë në sistem të gjithë dokumentet që disponon si dhe një genplan për të kryer kështu një regjistrim fillestar sporadik. ASHK, nëpërmjet SQDNE apo regjistrave që ajo disponon, do të verifikojë vërtetësinë e institucionit, do të regjistrojë pronën sipas procedurave standarde dhe do ta arkivojë pronën me dokumentacion, transaksione, gjeneralitete dhe të dhëna hartografike në sistem. Në këtë moment, të dhënat e pronës mund të jenë të disponueshme menjëherë në sistem shërbim nivel 4 në portalin e-albania.

Një nga pikat kyçe të sistemit është menaxhimi. ASHK ne kete drejtim, ka bere realitet nje ambicie, pasi nepermjet procesit te Riinxhinierizimit, qe u be realitet per here te pare me 3 korrik 2023, ku tashme çdo aplikim, menaxhohet nga sistemi me load balancing dhe shperndahet në mënyrë rastësore ne specialist random dhe ky i fundit do të duhet të kryejë procedurat përkatëse. Specialistët e tjerë, nuk kane dijeni kush menaxhon çfarë, pra edhe nëse dikush do të donte të kryente një akt korruptiv, do të detyrohej të kontaktonte të gjithë specialistet e ASHK, që banojnë ndoshta edhe në një qytet tjetër, për të përshpejtuar apo favorizuar procedurën.

#### **- Kadastra 3D (projekt për 2024)**

Nepermjet projektit Kadastra 3D do të mundesohet ofrimi në kohe reale i informacionit juridiko-gjeografik mbi vendndhodhjen e pronës, te dhenat gjeodezike të pronës në plan 3 D, proces i cili ndihmon ne procesin e planifikimit urban dhe të vlerësimit të pronave sëbashku me zhvillimin e infratsukturës dhe sigurisë.

Ky proces ndihmon ne permiresimin e shërbimeve qe ofron sektori privat dhe ai publik duke i bërë me efikase dhe transparente keto shërbime. Krijohet mundesia e reflektimit ne kohe reale e ndryshimeve qe behen ne planimetrite e objekteve, proces i cili shmang abuzimet në planifikimin urban, si dhe lehtëson proceset qe kane te bejne me planfikimin urban dhe qarkullimin civil të pronave.

## **OBJEKTIVAT PRIORITARE TË ASHK, PËR VITIN 2024 :**

Në përcaktimin e objektivave të ASHK-së, jemi kujdesur që objektivat të jenë SMART, pra specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të realizueshme në kohë. Objektivat renditen si më poshtë:

1. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme për vitin 2024:  
Realizimin e 1,150,000 shërbimeve ndaj klientëve. Realizimi i te ardhurave në vlerën 2,710,287,000 lekë
2. Legalizimi i objekteve informale.
3. Sigurimi i të ardhurave në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.  
Për planifikimin e shërbimeve dhe të ardhurave nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme, legalizimi dhe përpunimi i informacionit tekniko ligjor për ndërtimet informale jemi mbështetur në:  
Treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektivi, për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe të pritshmin 2023.
4. Dixhitalizimi i plotë i kartelave të pasurive të paluajtshme, ngarkimi dhe mbajtja në vazhdimësi të përditësuar.
5. Automatizimi i sistemit të regjistrimit dhe legalizimit të kadastrës për ASHK (mbështetur nga AKSHI cili do të realizojë aplikimin e shërbimeve on-line dhe ndërveprimin me institucionet e tjera nëpërmjet Upgradeve, softeve, mirëmbajtjeve, shërbimeve, në drejtim të përmirësimit të sistemit dixhital të kadastrës).
6. Ndërtimi i infrastrukturës së ASHK-së nëpërmjet rikonstruksionit të ambjenteve të punës së Drejtorive dhe Zyrave Vendore si dhe kompletimit të Drejtorive të ASHK-së me pajisje elektronike, orendi, etj.
7. Inventarizimi i të gjithë pronave shtetërore.
8. Ngritja e kapaciteteve të ASHK-së, nëpërmjet trajnimit të punonjësve.
9. Qendërzimi i Drejtorive Vendore në Rajone për dhënien e shërbimit në kohë reale dhe nëpërmjet sistemit online.
10. Fuqizimi i QKD.Në lidhje me QKD, është menduar që ky institucion të fuqizohet dhe të investohet mbi këtë të fundit, në burime njerëzore dhe infrastrukturë, në mënyrë që të rritet performanca dhe të arrihet qëllimi kryesor dhe sigurisht ambicioz, përfundimi i plote i regjistrimit fillestar të zonave të mbetura pa përfunduar, dixhitalizimi i plote i dokumentacionit ligjor dhe hartografik si dhe unifikimi i hartave digjitale në sistemin KRGJSH (Korniza referuese gjeodezike Shqiptare).